

Aktiviteti misionar në Shqipëri nën dritën e sinodeve plenare shqiptare të shekujve XVIII dhe XIX

1.0. Hyrje

Albanologët parapëlqejnë të mbrojnë tezën se, shqiptarët (*Albanoi/Arber*) janë pasardhësit e fiseve të vjetra ilire, të cilat qysh para epokës së “dyndjes së popujve” duhet të kenë populluar territorin e Shqipërisë së sotme dhe të shteteve sot fqinje si: Greqia, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi.¹ Pas ndarjes së Perandorisë Romake në vitin 395, këto fise ilire hynë politikisht nën juridiksionin e Bizantit, kurse nga ana kishtare vijuan të mbeteshin nën juridiksionin e Papës.² Në përfundim të “dyndjes së popujve” trevat iliro-shqiptare u copëtuan dhe shqiptarët u përzien pjesërisht si me sllavët e ardhur, ashtu edhe me mbetje të popullsisë së vjetër romane.³ Në Mesjetën e hershme dhe atë të mesme pati një simbiozë mes gjuhëve shqipe, greke dhe sllave, e cila vërehet ende sot në toponiminë e arealit shqiptar. Përmes kësaj simbioze gjuhësore shqiptarët përcollën një sërë termash liturgjikë tek sllavët.⁴ Nga mesjeta e këtej shqiptarët qenë rrethuar prej fqinjësh të fuqishëm si Bizanti, Normanët, Venediku, Mbretëria e

- 1 S. POLLO-A. PUTO, *Histoire de l'Albanie des origines à nos jours*, Roanne 1974, 25-30; M. SCHMIDT-NEKE, *Geschichtliche Grundlagen*, in: K.-D. GROTHUSEN (Hg.), *Albanien* (= Südosteuropa Handbuch VII), Göttingen 1993, 26-30; A. STIPČEVIĆ, *Die Frage der illyrisch-albanischen Kontinuität und ihre politische Aktualität heute*, in: *Dardania* 4(1995), 11-25; K. CLEWING, *An den Grenzen der Geisteswissenschaft: Albaner, Thraker und Illyrer*, in: M. GENESIN-J. MATZINGER (Hgg.), *Albanologischen und Balkanologischen Forschungen. Festschrift für Wilfried Fiedler*, Hamburg 2005, 215-225, këtu 223-224; J. MATZINGER, *Die Albaner als Nachkommen der Illyrer aus der Sicht der historischen Sprachwissenschaft*, in: O. J. SCHMITT-E. A. FRANTZ (Hgg.), *Albanische Geschichte. Stand und Perspektiven der Forschung*. München 2009, 13-36.
- 2 Ata i takonin Vikariatit të Selanikut, i cili ishte deri në mesin e shek. 8 nën juridiksionin e ipeshkvit të Romës. Kh. G. OSTROGORSKY, *Geschichte des byzantinischen Staates*, München 1963, 142; V. GRUMEL, *L'annexion de l'Illyricum oriental, de la Sicile et de Calabre au patriarcat de Constantinople*, in: RSR 40 (1952), 191-200; M. ANASTOS, *The transfer of Illyricum, Calabria and Sicily to the jurisdiction of Patriarchate of Constantinople in 732-733*, in: SBNE 9 (1957)14-31.
- 3 Kh. G. STADTMÜLLER, *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*, Wiesbaden 1966, 38-39; P. BARTL, *Albanien*, Regensburg 1995, 20.-21; J. KARAYANNOPULOS, *Zur Frage der Slavenansiedlung im griechischen Raum*, in: A. HOHLWEG (Hg.), *Byzanz und seine Nachbarn*, (= Südosteuropa- Jahrbuch 26), München 1996, 177-218.
- 4 O. J. SCHMITT, *Die Albaner. Eine Geschichte zwischen Orient und Okzident*, München 2012, 48-49; G. SCHRAMM, *Slawisch im Gottesdienst. Kirchenwortschatz und neue Schriftsprachen auf dem Wege zu einem christlichen Südeuropa*, (=SOA 129), München 2007, 26-30.

Napolit dhe Mbretëria Serbe. Për këtë arsye, fiset shqiptare të mesjetës nuk ia dolën të krijonin një mbretëri më vehte, ndonëse tashmë ishin krijuar disa principata të fuqishme.⁵ Pikërisht në këtë periudhë, u kristalizuan ndër shqiptarë dy grupe të ndryshme popullore, toskët dhe gegët, të cilët nuk ndryshonin veç nga gjuha, por edhe kulturalisht e fetarisht. Toskët në tërësi banonin territorin në jug të lumit Shkumbin, ishin prej fillimit në shumicë ortodokse dhe të ndikuar fort prej kulturës orientalo-qytetare të Bizantit, e më vonë prej asaj të Perandorisë Osmane. Në pjesën e ndodhur në veri të lumit Shkumbin jetonin kryesisht gegët, të cilët fillimisht ishin katolikë. Këta, deri në fillim të shek. XX ruajtën një kulturë fisnore arkaike prej popujsh malësorë e blegtorë. Një përjashtim të mirëfilltë përbënte vetëm qyteti shqiptaro-verior i Shkodrës, pasi deri në gjysmën e dytë të shek. 15^{-të} kishte qenë i dominuar nga venecianët, ishte i mbryjtur fort prej katolicizmit dhe, prej shek. XVIII-XIX ishte bërë djepi i Rilindjes shqiptare.

Në pikëpamje fetare, prej mesit të shek. VIII, treva e populluar shqiptare u kthye në mollë sherri mes Romës dhe Kostandinopojës. Rreth vitit 750, në kohën e ikonoklasmës, me dekret perandorak ky rajon u vu përfundimisht nën juridiksionin e Patriarkut të Kostandinopojës.⁶ Atëkohë, ende përpara skizmës së madhe mes Kishës Perëndimore e asaj Lindore të vitit 1054, Kisha në trevat e fiseve shqiptare u trondit thellë prej tensioneve teologjike e politike mes Lindjes dhe Perëndimit. Prej copëtimit politik të territorit, sidomos pas rënies përfundimtare të Vikariatit të Selanikut në mes të shek. VIII⁷, në territorin e fiseve shqiptare u ngritën shumë ledhe mbrojtëse, që u shërbenin përkatësisht dy zonave të mëdha të influencës, Romës e Kostandinopojës. Në një kohë kur Ohri⁸ dhe Durrësi⁹ shërbenin

5 Më 1190, regjenti i Krujës, Progon, arriti që ta pavarësonte territorin e tij administrativ prej bizantinëve. Ky është themelimi i parë i një principate vetiake shqiptare. Kontrollin mbi këtë territor do ta merrte më pas dinastia fisnike e Kastriotëve, prej së cilës do të vinte Skënderbeu. POLLO-PUTO, 45- 47.

6 OSTROGORSKY, 135; J. DARROUZÈS, *Listes episcopales du concile de Nicée (787)*, in: *Révue des études byzantines* 33 (1975) 5-76; G. FEDALTO, *La situazione canonico - giurisdizionale di Dalmazia ed Albania medievali nei rapporti con Roma e Costantinopoli*, in: *Le relazioni religiose e ecclesiastico-giurisdizionali. Atti del II. Congresso internazionale sulle relazioni fra le due sponde adriatiche* (Bari, 29-31 ottobre 1976), Roma 1979, 87-105.

7 J. RIST, *Das apostolische Vikariat von Thessaloniki als Beispiel der Begegnung zwischen Rom und Konstantinopel in der Spätantike*, in: R. HARREITHER-Ph. PERGOLA-R. PILLINGER- A. PÜLZ (Hgg.), *Akten des XIV. Internationalen Kongresses für Christliche Archäologie*, SAC 62, Città del Vaticano 2006, 649-662.

8 F. DÖLGER, *Regesten der Kaiserurkunden des oströmischen Reiches: Regesten von 867-1025*, München 2003, 218-219, H. GELZER, *Der Patriarchat von Achrída*, (Leipzig 1903) ND Aalen 1980, 3-4; M. LACKO, *Ochrida, centro ecclesiastico dell'Albania*, in: *Bollettino della Badia Greca di Grottaferrata*, 11(1957) 131-138; I. MURZAKU, *Catholicism, Culture, Conversion: The History of Jesuits in Albania (1841-1946)*, Roma 2006, 38.

9 M. LE QUIEN, *Oriens christianus* II, Paris 1840, 240; I. MURZAKU, 38-39.

si pararojë e pretendimeve ortodokse, bizantino-bullgaro-maqedone në Ballkanin perëndimor,¹⁰ po ashtu dhe Tivari (Stari Bar në Malin e Zi sot), i themeluar në shek. IX-të si pasues i Dioclea-s së vjetër, i cili kishte kaluar në vitin 1022 nën juridiksionin e Raguzës, dhe përmendet më 1043 si arqipeshkvi e ngritur në vitin 1089 në Metropoli nga antipapa Clement III, u shndërrua në përfaqësuesin kryesor të interesave katolike, romane dhe papnore në Adriatikun juglindor.¹¹ Kësisoj, nën varësinë e arqipeshkvisë së Tivarit, krahas ipeshkvive bregdetare, hynë gradualisht si shufragane edhe dioqezat malore shqiptare. Sa i përket skizmës së vitit 1054, mes Kishës Perëndimore e asaj Lindore, ajo nuk u ndje menjëherë në këtë rajon, porse gradualisht vulosi sferat e vjetra të interesave duke krijuar një vijë ndarëse virtuale midis dy Kishave të krishtera, e cila përshkonte mes për mes trevat shqiptare. Nga kjo ndarje që u formësua përfundimisht në shek. e 13-të, e që ruhet ende deri sot, u prekën jo vetëm popullsitë shqiptare e greke, por edhe popujt sllavë të bullgarëve, maqedonasve, serbëve, e më vonë edhe të malazezve.¹²

Pas depërtimit osman në Ballkan, nisur nga gjysma e shek. të 14, filloi një epokë e vështirë për të krishterët e të dyja Kishave të mëdha. Fakti që osmanët sollën në Ballkan një fe të re, jo të krishterë, nuk është një *novum* në histori. Por një *novum* për historinë europiano-juglindore është fakti se, kjo fe e re gjeti një përhapje proporcionalisht të shpejtë, kryesisht në Shqipëri, në Sanxhakun e sotëm dhe në Bosnje-Hercegovinë. Shkaqet për këtë duhen kërkuar më tepër tek varësia ligjore, sociale dhe ekonomike prej pushtuesit dhe administratës së tij, sesa tek zelli fetar për besimin e tij. Pas shpalljes së Kuranit, rregullave të së drejtës islamike (*fikh*) dhe parashtrimeve teologjike të dijetarëve islamikë, çdo mysliman bënte pjesë *ipso facto* në elitën sunduese politike të shtetit islamik, ndërkohë që të gjithë jo myslimanët ishin të përjashtuar krejtësisht prej të drejtave politike. Për të shmangur këtë gjë, si dhe për të ruajtur si më parë pronën vetjake dhe pozitën shoqërore në vendin e vet, aristokracia shqiptare pranoi islamin.¹³

10 OSTROGORSKY, 256-258; 417; H.-G. BECK, *Geschichte der orthodoxen Kirche im byzantinischen Reich*, Göttingen 1980, 131, 208; BARTL, *Albanien*, 39.

11 M. SUFFLAY, *Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien*, in: L. THALLOCHY (Hg.), *Illyrisch-Albanische Forschungen*, Bd 1, München-Leipzig 1916, 194-200; K. DRAGANOVIĆ (Hg.), *Opći šematizam katoličke crkve u Jugoslaviji*, Zagreb 1975, 639-641; MURZAKU, 39-40.

12 E. HÖSCH, *Das byzantinische Erbe bei den Balkanvölkern*, in: A. HOHLWEG (Hg.), *Byzanz und seine Nachbarn*, (= Südosteuropa- Jahrbuch 26), München 1996, 143-157.

13 A. FATTAL, *Le statut légal des non-musulmans en pays d'islam*, Beyrouth 1958, 236-240; G. STADTMÜLLER, *Die Islamisierung bei den Albanern*, in: *Jahrbücher für Geschichte Osteuropas* N.F. 3 (1955) 404-429., këtu 404-405; S. JUKA, *Alcune osservazioni sull'islamizzazione dell'Albania*, in: *Islam storia e civiltà* 2 (1985) 101-101; S. ZEFLI, *Islamization of Albanians through Centuries (15-20th Century)*, Prizren 2006, 88-123;

2.0. Katolicizmi shqiptar nën sundimin osman

Shqipëria veriore, malësia dhe ultësira e saj deri në Adriatik, ishte e populluar në shumicë dërrmuese prej shqiptarësh etnikë. Në shekujt 14 -15 këto krahina ranë fillimisht nën sundimin serb dhe më pas nën atë venedikas.¹⁴ Popullsia i takonte kryesisht grupit popullor të gegëve dhe shumica ishin katolikë. Zor se mund të gjendeshin katolikë të tjerë joshqiptarë, përjashtuar komunitetin kroat në Janjevo¹⁵ të Kosovës. Besimi dhe gjuha formonin një unitet të veçantë. Njëlloj si ortodoksët në jug të Shqipërisë, edhe katolikët e veriut të vendit ishin pjesë e një bote kulturore-fetare shumë më të madhe, e shtrirë kjo në Ballkan e në hapësirën e Adriatikut, ndërsa vijat përbashkuese kalonin nëpërmjet Kishës dhe tregtisë nëpër qytetet e Antivarit, Shkodrës, Durrësit dhe Prizrenit. Në qytetet bregdetare të Durrësit (Durazzo) dhe Vlorës (Valona), që përkohësisht qenë pjesë e Mbretërisë së Napolit dhe më vonë e Republikës së Venedikut, prej shek. XIII ka pasur hierarki dhe komunitete konkurruese katolike dhe ortodokse.¹⁶ Katolikët e Shqipërisë veriore i mbijetuan mirë sundimit jetëshkurtër të carit serb Dušan dhe përpjekjeve të tij që, nëpërmjet sistemit ligjor të mund të përhapte edhe ortodoksinë mes katolikëve shqiptarë.¹⁷ Pas vdekjes së carit në vitin 1355, sundimin mbi Shqipërinë veriore e mori familja princërore e Balshajve (Balšići), që ishte konvertuar në katolicizëm, për t'u zëvendësuar më pas, në shek. XV, prej dinastisë Crnojević. Thuajse në të njëjtën kohë osmanët filluan të depërtonin në Ballkan. Katolikëve shqiptarë u takoi detyra historike që të ndalnin marshimin osman në Shqipërinë veriore e qendrore. Në këto përpjekje spikatën në shek. XV mbi të gjithë princi Gjergj Kastrioti, i quajtur Skënderbe (1405-1468) dhe arqipeshkvi i Durrësit, Pal Engjëlli (1416-1470), të cilët lidhën një aleancë antiosmane me Papën, Venedikun, Republikën e Raguzës dhe Hungarinë, çka veç sa munda ta vonojë edhe për disa dekada

M. KOLLER, *Albaner im Osmanischen Reich - ein historiographischer Überblick* (17. und 18. Jahrhundert), in: SCHMITT, *Albanische Geschichte*, 81-105; N. CLAYER, *Religion, Nationsbildung und Gesellschaft*, in: SCHMITT, *Albanische Geschichte*, 107-118.

14 O. J. SCHMITT, *Das Venezianische Albanien (1392-1479)*, München 2001, 47-61.

15 Janjevo u themelua në shek. 13 prej tregtarëve dhe malësorëve kroatë nga Dubrovniku, Bosnja dhe Hum. Papa Benedikti XI e përmend Janjevon dhe bashkësinë e tij të Shën Kollit në një shkresë drejtuar arqipeshkvit Marin të Tivarit në vitin 1303. Khrrs. C. JIREČEK, *Geschichte der Serben II*, Gotha 1918, 331; M. J. DINIĆ, *Trepča u srednjem veku*, in: *Prilozi za književnost, jezik, istoriju i folklor*, SANU, Beograd 33 (1967), 3-10, 400-409; Ž. ŠILJKOVIĆ-M. GLAMUZINA, *Janjevo and Janjevci - From Kosovo to Zagreb*, in: *Geoadria Zadar* 1(2004), 89-109, këtu 90-91.

16 I. MURZAKU, *Catholicism, Culture, Conversion: The History of Jesuits in Albania (1841-1946)*, Roma 2006, 42-43.

17 M. SUFFLAY, *Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien*, in: L. THALLOCHY (Hg.), *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, München-Leipzig 1916, 244.

pushtimin e Shqipërisë.¹⁸ Skënderbeu vdiq i pamposhtur më 1468. Venediku mori sundimin mbi krahinat e mbetura të Shqipërisë, i mbrojti ato me guxim, duke u detyruar më në fund t'ia dorëzonte ato Sulltanit me Paqen e 25 prillit 1479, e deri tek Durrësi që u mor nga osmanët më 1501.¹⁹ Viti 1479 ka hyrë kështu në historiografi si fillimi i sundimit osman mbi tërë Shqipërinë. E ky sundim do të zgjaste deri më 28 nëntor 1912.

Duhet pranuar se, deri në fund të shek. XVI në Shqipërinë e mesme dhe atë veriore ishte kthyer në myslimane një pjesë e konsiderueshme e popullsisë qytetare, ndërsa mbi 80% e popullsisë në fshatra ishte e krishterë. Kështu raportonte më 1610 me plot entuziazëm arqipeshkvi i Tivarit, Marin Bici, se në Shqipërinë veriore vetëm 10% e popullsisë ishte bërë islamike.²⁰ Pak kohë më vonë do të ndryshonte situata politike dhe ekonomike në Perandorinë Osmane. Në shek. XVII, pas Luftës së Kretës²¹ dhe Luftës së Madhe turke, osmanët u tërhoqën gjithnjë e më tepër në pozita mbrojtëse kundrejt Fuqive të krishtera të Europës.²² Qendra e Perandorisë Osmane pësoi rënie ekonomike dhe sistemi feudal-ushtarak (*timar*) po shpërbëhej. E gjitha kjo e rriti shtypjen dhe e ashpërsoi më tej shfrytëzimin e fshatarëve të krishterë nga ana e çifligarëve të mëdhenj.²³ Katolikët kishin si alternativë: arratinë ose pranimin e islamit. Shumë prej tyre panë si rrugë të vetme konvertimin. Prandaj, për t'i shpëtuar së paku taksës për kokë (*gizya*) që duhej ta paguanin të krishterët (katolikët), qytete e fshatra të tëra kaluan në islam

18 S. MASCI, *Le relazioni Italo-Albanesi al tempo di Giorgio Castriota Scanderbeg*, in: *Rivista d'Albania* 19 (1941) 163-173; A. SERRA, *L'Albania e la Santa Sede ai tempi di G. C. Scanderbeg*, Cosenza 1960, 23-53; SCHMITT, *Das Venezienische Albanien*, 295-314.

19 P. BARTL, *Albanien*, Regensburg 1955, 44-48. SCHMITT, *Das Venezienische Albanien*, 595-628.

20 F. RAČKI, *Izveštaj barskog nadbiskupa Marina Bizzia o svojem putovanju god. 1610 po Arbanaskoj i staroj Srbiji*, in: *Starine* 20 (Zagreb 1888), 50-156; G. STADTMÜLLER, *Visitationsreise des Erzbischofs Marino Bizzi*, in: H. J. KISSLING - A. SCHMAUS (Hgg.), *Serta Monacensia*. Franz Babinger zum 15. Januar 1951 als Festgruß dargebracht, Leiden 1952, 184-199; P. BARTL, *Albanien*, 51; ID., *Die katholische Kirche im Mittelalter und unter osmanischer Herrschaft*, in: O. J. SCHMITT (Hg.), *Religion und Kultur im albanischsprachigen Südosteuropa*, Frankfurt am Main 2010, 53-68.

21 N. JORGA, *Geschichte des Osmanischen Reiches nach den Quellen dargestellt*, (Gotha 1908-1913) 4, ND Frankfurt/Main 1990, 16-134.

22 P. BARTL, *Albanien*, 67-73.

23 M. KOLLER, *Albaner im Osmanischen Reich - ein historiographischer Überblick* (17. und 18. Jahrhundert), in: SCHMITT, *Albanische Geschichte*, 92-96. Por edhe ky këndvështrim i përgjithshëm mbetet pjesërisht i pasaktë. Në vitin 1600 vihen re dallime thelbësore dhe kryesisht mes qytetit e fshatit. Në fakt vende të rëndësishme në lindje të malësisë - Prizren, Peć, Priştina, Vuçitrn, Tetovo, Ohrid, Struga - ishin shumë më tepër të islamizuara sesa vendabnimet në jug, gjatë bregut jonian dhe në kufi me Epirin, si p.sh. Berat, Vlora, Gjirokastra, Kanina, Kelcyra, Delvina, Permeti dhe Korfa, të cilat deri më 1550 ishin ende thujse krejt të krishtera. Khrs. STADTMÜLLER, *Die Islamisierung bei den Albanern*, 408-410.

përgjatë shekujve 17 dhe 18 dhe, kështu Shqipëria u kthye në një vend me shumicë myslimane.²⁴ Pikërisht këto shkaqe shoqërore dhe ekonomike, që shpesh shërbenin si motivacion për ndërrimin e fesë, çuan drejt fenomenit që disa të konvertuar të quajtur *laraman* vazhduan fshehurazi të praktikonin fenë e tyre të vjetër. Shpesh konvertohej në islam vetëm kreu i familjes, kurse pjesëtarët e tjerë e ruanin fenë e mëparshme. Përveç kësaj, lindën edhe forma të një sinkretizmi islamo-kristian. Për rrjedhojë, në veri të Shqipërisë ishte e zakonshme që edhe fshatarët myslimanë të kërkonin uratën katolike për bagëtitë e tyre dhe, kjo uratë u jepej prej priftërinjve katolikë.²⁵

Qëndresa e suksesshme e katolikëve shqiptarë kundër osmanëve në shek. XIV dhe XV nuk përbën veç një dëshmi heroike për mbrojtjen e vendit të tyre, por dhe një kontribut heroik për mbrojtjen e Europës, dhe si i tillë u përcoll me mirënjohje qysh atëherë prej bashkëkohësve.²⁶ Në anën tjetër të kësaj qëndrese historike të suksesshme qëndron fakti se ajo çoi në rënien e institucioneve katolike dhe në humbjen e jetës kishtare ndër katolikët e Shqipërisë veriore. Pas pushtimit osman katedralet u shkatërruan ose u shndërruan në xhami, siç p.sh. në Lezhë ose Tivar më 1571. Ipeshkvijtë ose ikën në arrati, ose ranë në robëri osmane, prej së cilës zor se mund të shpëtoje. Pronat kishtare, mbi të gjitha ato ipeshkvnore, u rrëmbyen. Dioqezat mbetën një kohë të gjatë jetime, ose vetëm sa mbuloheshin prej ipeshkvijve

24 STADTMÜLLER, *Die Islamisierung bei den Albanern*, 412; P. THËNGJILLI, Renta feudale dhe evoluimi i saj në vise shqiptare (shek. XVII- mesi i shek. XVIII), Tirana 1990, 43-47; BARTL, *Albanien*, 52; KOLLER, 88-92.

25 Këtu duhet konsideruar bashkëjetesa mes myslimanëve dhe të krishterëve brenda fisit, fshatit dhe familjes. Kjo gjë shpesh çoi në përzierjen e besimeve fetare. Gratë, si myslimane dhe të krishtera, i pagëzonin fëmijet e tyre, kurse festat e krishtera festoheshin bashkarisht nga myslimanë e të krishterë. Myslimanët bënë pelegrinazh në vendet e shenjta të të krishterëve dhe anasjelltas, kishte pelegrinë të krishterë që vizitonin varret e shenjtoreve lokalë myslimanë. Khrr. STADTMÜLLER, *Die Islamisierung bei den Albanern*, 406-407; P. BARTL, *Kryptochristentum und Formen des religiösen Synkretismus in Albanien*, in: *Grazer und Münchener Balkanologische Studien*. München 1967, 117-127; L. ROSTAGNO, *Note sulla simulazione di fede nell'Albania ottomana*, in: *La bisaccia dello Sheikh. Omaggio ad Alessandro Bausani islamista nel sessantesimo compleanno*, Venezia 29 maggio 1981, Venezia 1981, 153-163; G. GINI, *Ipeshkvia Shkup-Prizren neper shekuj*, Prizren, Zagreb-Prizren 1986, 147-154; H.Th. NORRIS, *Islam in the Balkans. Religion and society between Europe and the Arab World*, London 1993, 48; N. MALCOM, *Kosovo, a short history*, London, 1998, 129-132, ZEFI, 127-148.

26 Për këtë, merita kryesore i takon biografit të Skënderbeut, Marin Barleti. Khrr. M. BARLETIUS, *Historia de vita et gestis Scanderbegi Epirotarum principis*. Romae 1510. Botimi gjermanisht: *Des aller streytparsten und theuesten Fürsten und Herrn Georgen Castrioten, genannt Scanderbeg ... ritterliche thaten* / von Marinus Barletius, durch Joannem Pinicianum newlich verteutscht. Augsburg 1533.

titullarë.²⁷ Në Lezhë²⁸ dhe Shkodër ipeshkvijtë u rikthyen vetëm duke u nisur prej vitit 1575^{-ës}, në Sapë prej vitit 1582, në Durrës prej 1640 dhe në Pult në vitin 1668.²⁹ Të gjithë ipeshkvijtë e kishin selinë në ndonjë prej fshatrave fqinje. Kur prej osmanëve u mor edhe ipeshkvia e fundit shqiptare në Tivar më 1571, izolimi ndaj Perëndimit u bë edhe më i dukshëm. Të gjitha këto çuan në faktin që katolicizmi shqiptar shumë pak u ndikua prej reformave të Koncilit të Tridentit, e thuajse aspak prej frymës humaniste europiane të kohës.

Në këtë kuadër, disa klerikë shqiptarë u përpoqën që të përmirësonin sadopak situatën duke plotësuar mungesat klerikale të bashkatdhetarëve të tyre dhe lehtësuar punën e priftërinjve të thjeshtë. Ata bënë përkthime veprash fetare të njohura atëkohë dhe u mundësuan vendasve të mësonin shqipen dhe gjuhë të tjera. Të gjithë këta klerikë shqiptarë ishin arsimuar në Itali. Veprat e tyre janë dëshmitë më të hershme të literaturës shqipe. I pari që vlen të përmendet këtu është arqipeshkvi i sipërpërmendur i Durrësit, Pal Engjëlli, prej të cilit është trashëguar e para fjali e shkruar në shqip, Formula e Pagëzimit, e vitit 1462.³⁰ Autori i dytë i rëndësishëm është prifti Gjon Buzuku, që vepronte jashtë vendit. Në vitin 1555, në kohën e Koncilit të Trentit (1542-1563), ai përktheu dhe botoi në shqip *Missale Romanum*, Mesharin.³¹ Pjetër Budi (1566-1622), ipeshkëv i dioqezës së Sapës dhe Sardës në Shqipërinë e veriut, përktheu në shqip veprën e Robert Bellarmino-s *Christianae doctrinae explicatio*, nën titullin: *Doktrina e Kërshtenë*. Me këtë ai renditet i pari në historinë e letërsisë së popullit të tij. Me këto vepra ai synoi të forconte besimin fetar tek minoriteti i dobësuar katolik i vendit të tij, dhe njëkohësisht të nxiste Romën dhe shtetet e krishtera që të mbështesnin kryengritjen antiturke në Shqipëri.³² Ipeshkvi i Sapës,

27 P. BARTL, *Über die Priesterausbildung im katholischen Nordalbanien*, in: B. DEMIRAJ (Hg.), *Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925 - 1992) gewidmet*, (Albanischen Forschungen=29), Wiesbaden 2010, 499-519, këtu 499.

28 P. BARTL (Hg.), *Albania Sacra. Geistliche Visitationsberichte aus Albanien 1: Diözese Alessio*, Wiesbaden 2007, 14-16.

29 P. BARTL, *Über die Priesterausbildung im katholischen Nordalbanien*, 499.

30 J. BYRON, *Selection among alternates in language standardization. The case of Albanian*. Mouton 1976. 36; D. GASHI - I. STEINER, *Albanien*, Wien 1997, 77.

31 Gjon Buzuku vinte prej Shqipërisë veriore. Ai jetoi në shek. e 16 dhe kaloi një kohë të gjatë në territorin e Republikës së Venedikut, ose direkt në këtë qytet. Buzuku ishte me siguri një murg françeskan dhe sipas të dhënave edhe ipeshkëv i një prej dioqezave shqiptaro-veriore, çfarë nuk mund të vërtetohet me siguri. Ajo pak çfarë dimë mbi Buzukun, rrjedh prej kolofonit të shkruar nga ai vetë në faqen e fundit të *Mesharit*. Ky libër i tij paraqet të parin libër të botuar në shqip. M. CAMAJ, *Il "Messale" di Gjon Buzuku. Contributi linguistici allo studio della genesi*. Roma 1960.

32 R. ELSIE, *Albanian Literature. An Overview of its History and Development*. in: *Österreichische Osthefte. Sonderband Albanien* 17(2003) 243-276.

Frang Bardhi (1606-1643)³³, ishte i pari që hartoi një fjalor latinisht-shqip, të cilin e shtypi në Romë më 1635.³⁴ Duhet përmendur edhe Pjetër Bogdani (1630 - 1689), ipeshkëvi i Shkodrës-t, më vonë arqipeshkëvi i Shkupit, si autor i rëndësishëm i letërsisë së hershme shqipe. Libri i tij *Cuneus Prophetarum* (1685) është vepra e parë e rëndësishme në prozën shqipe.³⁵ Megjithëkëto përpjekje, numri dhe arsimimi i priftërinjve në Shqipëri në fillim të kësaj kohe ishte ende në nivel të ulët.³⁶ Ata të paktë rishtarë shqiptarë që patën fatin të shkojnë jashtë vendit në shek. XVI-XVII, u arsimuan në *Collegium Illyricum* në Loreto³⁷, ose më vonë në *Collegium Urbanum* në Romë.³⁸ Pjesa tjetër ishte e detyruar të kënaqej fillimisht duke shërbyer vite me radhë pranë një famullitari, për të mësuar tek ai gjërat më të nevojshme, e për t'u shuguruar një ditë prej ndonjë ipeshkvi. Për rrjedhojë, kushtet nëpër dioqeza ishin të mjerueshme. Më poshtë po përmendim disa shembuj nga shek. XVII, për të ilustruar gjendjen e kishave katolike në Shqipërinë veriore të kësaj periudhe. Një nga ipeshkvijtë e parë që u kthyen sërish në atdhe ishte p.sh. Nicolò Mechaisci, bari i ipeshkvive *Stefanense* dhe *Bendense*, dhe vizitator apostolik në Shqipëri, i cili në 1603 nuk gjeti më shumë se 130 priftërinj për rreth 150.000 katolikë. Për pasojë, shumë katolikë u kthyen nga islami ose ortodoksia.³⁹ Në vitin 1634, vizitatori apostolik Bonaventura da Palazzolo, përshkruan dioqezën shqiptaro-veriore të Pultit. Ai raporton se, në vitin 1634 për 20.000 katolikë kishte vetëm dy klerikë, njëri prej të cilëve as nuk çohet dot në këmbë prej moshës.⁴⁰ Ipeshkvi i sipërpërmendur

33 P. GACHAT (Hg.), *Hierarchia catholica medii et recentioris aevi* IV, Münster 1935, 305.

34 *Dictionarium Latino Epiroticum*. Cum nonnullis usitatoribus loquendi formulis. Romae 1635.

35 GASHI - STEINER, 77; Sh. OSMANI, *Pjetër Bogdani*. Tirana 1996.

36 P. BARTL, *Über die Priesterausbildung im katholischen Nordalbanien*, 499-519.

37 Ky Kolegj u themelua më 1581 nga Papa Gregori XV dhe u zhvendos disa herë. Ai ishte parashikuar për kroatët nga Dalmacia, Bosnja dhe Sllovenia. Në të bënë pjesë edhe disa bullgarë e shqiptarë. Në historinë e tij 300 vjeçare, Kolegji u vizitua nga mbi 1000 studentë kroatë. Ai u mbyll prej qeverisë italiane më 1860. Për më shumë shih: Đ. KOKŠA, *L'organizzazione periferica delle Missioni in Ungheria e in Croazia*, in: J. METZLER (Hg.), *Sacrae Congregationis de Propaganda Fide memoria rerum. 350 anni a servizio delle missioni*. 1622-1972, I/2, 1622-1700, Rom 1972, 274-291, këtu 284.

38 *Collegium Urbanum* është i lidhur ngushtë me Kongregacionin e Propagandës dhe u ngrit më 1627 si Seminar dhe universitet prej Papës Urban VIII. Khars. M. JEZERNIK, *Il Collegio Urbano*, in: METZLER (Hg.), *Sacrae Congregationis de Propaganda Fide memoria rerum* I/1, Rom 1971, 465-482, këtu 467.

39 *"Et per mancamento di operai ogni giorno vanno mancando li Christiani queste parti, parte vanno alla perfida setta di Mahometto, et parte si fanno Greci, et Serviani."* Nicolò Mechaisci an Kardinal Cinzio Aldobrandini, 27. Juli 1603, ASV, Venezia vol. 33, f. 321-322; BARTL, *Über die Priesterausbildung im katholischen Nordalbanien*, 500.

40 *"Li popoli di Pullati sono numerosi et bellicosi per la penuria di preti sono alcuni fatti Turchi ma pochissimi questi Pullati fanno più di uintimilla anime cristiane hanno solo*

i Sapës, Frang Bardhi, i shkruante Romës më 1635 mbi fisin e Kelmendit në malësinë e Shkodrës se, njerëzit atje nuk mbanin mend qëkur kishin parë ndonjëherë ndonjë ipeshkëv dhe zor të dinte kush se çfarë ishte një meshë e shenjtë.⁴¹ Nga raporti baritor i Stefano Gaspari mbi dioqezën e Lezhës në vitet 1671/72 lexojmë se, prej 19 klerikëve që janë në shërbim vetëm njëri dinte shkrim e këndim, 7 kishin aftësi minimale në lexim.⁴² Më 1672 vizitatori kontrolloi 20 famullitarë në arqipeshkvinë e Durrësit, nga të cilët 7 mundën të lexonin mirë, 13 kishin vetëm pak njohuri leximi dhe vetëm njëri mundi të shkruante diçka.⁴³ Përjashtim bënin ipeshkvijtë e sipërpërmendur shqiptaro-veriorë, misionarë dhe priftërinj që ishin arsimuar jashtë vendit, që luanin një rol jo veç kishtar, por edhe kombëtar-iluminist dhe që ishin vënë madje në krye të kryengritjeve përfundimisht të pasuksesshme.⁴⁴

Në të gjithë Ballkanin osman kisha katolike u ruajt, u mbështet dhe u koordinua prej *Congregatio de Propaganda Fide* (Kongregacioni për Përhapjen e Fesë), themeluar qysh më 1622, me seli në Romë.⁴⁵ Ky institucion mbikqyrte dhe mbështeste kishat katolike në zonat jokatolike, me anë të vizitave të rregullta baritore.⁴⁶ Në përgjithësi, kleri i lartë, shpesh jovendas, ishte i prirur drejt raporteve të mira me autoritetet osmane, dhe në një moment të tillë të marrëdhënieve shumë pozitive me sundimtarin e Shkodrës, u mbajt më 1703 i ashtuquajtur i Koncili Kombëtar i Arbërit, (Kuvendi i Arbënit) i cili duhej të rregullonte mangësitë e keqadministrimit brendapërbrenda Kishës.

Për katolikët shqiptarë të veriut, sidomos për klerin, një pikë të rëndësishme reference krahas Romës dhe Italisë, paraqesnin edhe katolikët kroatë në Dalmaci, Bosnje dhe Kroaci veriore. Një vend të posaçëm si ndër shqiptarët katolikë ashtu dhe ndër kroatët katolikë në Dalmaci e Bosnje zuri

doi sacerdoti uno penso non possa moversi da terra per la vecchieza". F. CORDIGNANO, *Geografia ecclesiastica dell'Albania. Dagli ultimi decenni del secolo XVI alla metà del secolo XVI*, in: OC 4(1934) 229-294, këtu 245.

41 P. BARTL, *Albanien*, 53; S. PAÇUKAJ, *Albania. Antropografia degli anni '20*, Roma 2012, 149-150.

42 P. BARTL, *Albania sacra* 1,108, 122.

43 Visitationsbericht über die Erzdiözese Durazzo 1672: AP. Visite e Collegi 34, fol. 75-101. P. BARTL, *Die katholische Kirche*, 58.

44 P. BARTL, *Albanien*, 84-88.

45 J. METZLER, *Foundation of the Congregation "de Propaganda Fide" by Gregory XV*, in: J. METZLER (Hg.), *Sacrae Congregationis de Propaganda Fide memoria rerum* I/1, 79-111, këtu 86-98.

46 Sa i përket Misionëve në Shqipëri, me rëndësi është studimi i Pandžić. Khrs. B. PANDŽIĆ, *L'opera della S. Congregazione per le popolazioni della Penisola Balcanica centrale*, in: J. METZLER (Hg.), *Sacrae Congregationis de Propaganda Fide memoria rerum* I/2, 292-315, këtu 309-314.

Urdhri Françeskan, si në lidhje me udhëheqjen e besimtarëve ashtu dhe në kultivimin e një vetëdijeje historike-rajonale, kombëtare dhe fetare.⁴⁷ Rëndësia e klerit katolik shkonte edhe përtej sferës fetare. Shkrimet e para shqipe u hartuan kryesisht prej klerikëve katolikë mes shekujve XVI-XVIII dhe u shtypën më së shumti në Romë. Kështu p.sh., prej françeskanit dhe misionarit italian në Shqipëri, Francesco Maria da Lecce, u hartuan më 1702 (*Dizionario italiano-albanese*) dhe më 1716 gramatika e parë e gjuhës shqipe (*Osservazioni grammaticali nella lingua albanese*), të shtypura dhe botuara nga Propaganda Fide.⁴⁸ Kultura kroato-katolike në Dalmaci e Bosnje i dha impulse të rëndësishme arealit shqiptaro-katolik: pesë gërma të posaçme në librin e parë të shtypur shqip, Meshari i Gjon Buzukut i përmendur më lart, rrjedhin prej të ashtuquajturit shkrim *Bosančica*, që madje ishte në përdorim liturgjik tek kroatët katolikë në Bosnje-Hercegovinë, Dalmaci dhe Istri.⁴⁹ Përfaqësuesit më në zë të kulturës katolike, shqiptaro-veriore të shek. XIX-XX, siç ishin fillimisht jezuiti e më pas prifti dioqezan Ndrë Mjedja (1866-1937)⁵⁰, bashkë me fratin françeskan Gjergj Fishta (1871-1940),⁵¹ ishin arsimuar pjesërisht në arealin kroat ose atë kroato-bosnjak. Ndërsa Fishta ishte i familjarizuar me variantin boshnjako-françeskan të një patriotizmi të ravijëzuar në trajta fetare, Mjedja u shpalos, falë qëndrimeve të tij afatgjata në Kroaci, Itali, Francë, Spanjë dhe Poloni, si një si një poliglot universal dhe si europiani i parë i vërtetë mes gjithë shqiptarëve. Njëlloj siç ishin ndërlidhur mes tyre serbët, bullgarët, maqedonasit, malazeztë dhe shqiptarët ortodoksë përmes greqishtes apo alfabetit cirilik të Stambollit, Athinës, Selanikut e deri në Kiev dhe Moskë, edhe të krishterët katolikë në Europën Juglindore, kroatë, shqiptarë, maqedonas katolikë, bullgarë dhe grekë, nëpërmjet alfabetit latin, grek dhe atij glagolitik ishin po ashtu pjesë e një areali kulturor rajonal.⁵²

Fakt është se, zonat katolike të Shqipërisë veriore ishin dukshëm më të varfra dhe më pak të populluara sesa trevat ortodokse të Shqipërisë jugore. Gjithashtu kishte një distancë mirëqenieje ekonomike dhe arsimore, e cila ndan deri më sot veriun katolik prej jugut ortodoks, një distancë e krijuar prej tregtisë, emigrimit dhe marrëdhënieve me jashtë. Përrjashtim në veri

47 I. MURZAKU, 49-52.

48 M. F. DI MICELI, *Francescani in Albania*, in: Maria Francesca Di Miceli, *Francescani in Albania*, Padova 2011, 27-36.

49 Mbi përhapjen e Bosančica-s në shek. 16-17, shih: E. HERCIGONJA, *Bosnačica*, in: *Enciklopedija Jugoslavije* 2, Zagreb 1982, 88-92.

50 ELSIE, 243-276. Për komunistët shqiptarë Mjedja ishte paraardhësi i parë i Realizmit Socialist. Kh. I. MURZAKU, 25.

51 Kh. M. LAMBERTZ, *Gjergj Fishta und das albanische Heldenepos „Lahuta e Malsisë“ – Laute des Hochlandes. Eine Einführung in die albanische Sagenwelt*, Leipzig 1949; R. ELSIE, *Literature*, in: GROTHUSEN (Hg.), *Albanien*, 654.

52 I. MURZAKU, 56-66.

bënte qyteti i Shkodrës, që gjatë periudhës osmane i shërbente katolikëve si një portë ndërlidhëse me botën e jashtme.⁵³ Megjithëkëtë, në veriun katolik gjejmë gjurmë të para të sistemit shkollor shqiptar, falë Urdhërave misionarë katolikë, kryesisht françeskanë e jezuitë. Ishte françeskani italian Giacinto da Sospitello, ai që më 1638 hapi të parën shkollë në Pëdhana, dioqeza e Sapës, çka në vitet e dekadat në vijim u pasua me themelimin e shkollave të tjera. Para shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, Shqipëria veriore ishte e mbuluar thuajse anekënd nga një rrjet shkollash katolike të financuara nga Urdhërat fetarë.⁵⁴

2.1. Strukturat dhe prania katolike në Shqipëri nën sundimin osman

Në pikëpamje kishtare, prej Mesjetës së vonë e deri në shek. XX, trevat e banuara shqiptare shtriheshin në katër arqipeshkvi: Tivari në Malin e Zi sot, Shkodra dhe Durrësi në Shqipëri, si dhe Shkupi në Maqedoninë e sotme. Shkupi hyri qysh në vitin 1392 nën sundimin osman, Shkodra u pushtua prej turqve më 1479 pas një rrethimi të gjatë, Durrësi iu nënshtrua osmanëve më 1501 dhe Tivari ra më së fundi 1571 në duart osmane.⁵⁵

2.1.1. Arqipeshkvia Antivari/Bar/Tivar

Arqipeshkvia bënte pjesë në Provincën Kishtare të Shqipërisë dhe ishte qendra kishtare më e rëndësishme e vendit. Për herë të parë si arqipeshkvi përmendet më 1043, ndërsa në metropoli u ngrit më 1089 prej antipapës Klement III. Tivari avancoi gradualisht në përfaqësuesin kryesor të interesave katolike, romane dhe papnore në Adriatikun juglindor.⁵⁶ Kështu metropolisë, krahas ipeshkvive të gjendura në bregdetin adriatik dhe në ultësirën shqiptaro-veriore, si Kotorri, Budva, Ulqini, Shasi, Shkodra dhe Lezha, iu bashkuan si shufragane edhe dioqezat malore shqiptare të Sapës, Danjës, Sardës, Drishtit, Pultit dhe Prizrenit. Para pushtimit osman ajo kishte tetë ipeshkvi shufragane nën juridiksion, prej të cilave gjatë periudhës osmane mbetën vetëm katër në veri të vendit: Shkodra, Sapa, Pulti dhe Lezha.⁵⁷ Kur pushtuan Tivarin më 1571, turqit e shndërruan

53 P. BARTL, *Albanien*, 82-84.

54 D. KURTI, *Vepra kulturele e elementit katolik në Shqipëri (Kulturelle Werke des katholischen Elements in Albanien)*, Shkodër 1935, 11-15; M. PETERS, 7-8.

55 P. BARTL, *Albanien*, 40-48; L. TACHELLA, *Le diocesi dell'Albania nell'epoca posttridentina*, in: *Studia Borromasca* 5(1991), 161-189; F. GRANATA, *L'Albania e le missioni italiane nella prima metà del secolo XVII in base a documenti inediti*, in: *Rivista d'Albania* 3/1942, 226-248.

56 M. SUFFLAY, *Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien*, in: L. THALLOCHZY(Hg.), *Illyrisch-Albanische Forschungen*, Bd 1, München-Leipzig 1916, 194-200; K. DRAGANOVIĆ (Hg.), *Opći šematizam katoličke crkve u Jugoslaviji*, Zagreb 1975, 639-641; I. MURZAKU, 39-40.

57 P. BARTL (Hg.), *Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17. und 18.*

katedralen në xhami. Arqipeshkvit, i cili nuk mund të banonte dot më në Tivar, iu desh të arratisëj drejt dioqezës fqinje të Budvës, që ndodhej në territor venedikas. Gjatë vizitës së tij baritore në arqipeshkvinë e Tivarit më 1703, arqipeshkvi Zmajević gjeti aty pesë famulli dhe 2.144 katolikë.⁵⁸ Arqipeshkvijtë e Tivarit mund të komunikonin pa pengesa me Romën, duke mundur edhe të zbatonin pjesërisht direktivat e rëndësishme që vinin prej saj.⁵⁹ Intoleranca osmane vazhdoi deri në gjysmën e dytë të shek. XIX. Vetëm në vitet 1857-1858 u arrit të ndërtohej një rezidencë dhe arqipeshkvi hyri në Tivar. Në 1867 Papa Piu IX e bashkoi arqipeshkvinë e Tivarit me ipeshkvinë e Shkodrës dhe e zhvendosi këtu edhe selinë e arqipeshkvisë. Në harkun kohor 1867-1886 arqipeshkvia kishte nën juridiksion ende të njëjtat dioqeza shufragane.⁶⁰ Tivari u pushtua nga Mali i Zi më 1878 dhe u shkëput kështu prej territorit të Perandorisë Osmane. Në marrëveshjen mes Selisë së Shenjtë dhe principatës së Malit të Zi në 18 gusht 1886, Tivari u shkëput prej lidhjes me dioqezat shqiptare të veriut dhe iu nënshtrua drejtpërsëdrejti Romës.⁶¹ Principata ortodokse e Malit të Zi njohu juridiksionin e arqipeshkvisë së re mbi tërë katolikët e Malit të Zi dhe i siguroi një pagë të denjë vjetore. Në vitin 1887 arqipeshkvia e Tivarit numëronte vetëm 4.494 katolikë, 11 famulli, 6 priftërinj dioqezanë dhe 6 rregulltarë.⁶² Në famullitë flitej shqip, kroatisht, serbisht dhe turqisht. Duke qenë e mendimit se tërë katolikët shqipfolës duheshin sllavizuar, qeveria malazeze ia nisi këtij plani fatkeq prej vitit 1878.⁶³

2.1.2. Arqipeshkvia Skutari/ Shkodër

Ipeshkvia e Shkodrës është një themelim i vjetër që daton qysh prej shek. IV. Si një dioqezë shufragane, ajo ka qenë nën juridiksionin e metropolive të ndryshme: Selanikut, Justiniana Prima, Ohrit, Durrësit dhe Tivarit. Politikisht ajo ishte nën ndikimin e bizantinëve, bullgarëve, serbëve dhe venedikasve. Siç u përmend më sipër, më 1479 Shkodra hyri nën sundimin osman dhe mbeti kështu deri më 1912. Sipas relacionit të vizitatorit

Jahrhundert 2 (= Albanische Forschungen (AF) 20), München 1979,16; ID., *Die katholische Kirche im Mittelalter und unter osmanischen Herrschaft*, in: O. J. SCHMITT (Hg.), *Religion und Kultur im albanischsprachigen Südosteuropa*, Frankfurt am Main 2010, 54.

58 P. BARTL, *Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte*, 17.

59 B. PANDŽIĆ, *L'opera della S. Congregazione*, 310.

60 R. RITZER - P. SEFRIN (Hg.), *Hierarchia catholica medii et recentioris aevi VIII*, Padua 1978, 106

61 A. MERCATI, *Raccolta di concordati su materie ecclesiastiche tra la Santa Sede e le autorità civili* (1098-1914) I, Roma 1949, 1048; E. DEUSCH, *Das k.(u.)k. Kultusprotektorat im albanischen Siedlungsgebiet*, Wien 2009, 91-92.

62 APF, *Albania*, vol 43, fol. 846; RITZER – SEFRIN, *Hierarchia catholica VIII*, 106.

63 I. JOVOVIĆ, *Iz prošlosti Dukljansko-Barske nadbiskupije*, Bar 2004, 165-197.

Zmajević, në këtë qytet më 1702 jetonin rreth 6.000 banorë, shumë pak prej të cilëve ishin të krishterë. Ipushkvia kishte rreth 12.676 katolikë dhe 1.531 shtëpi katolike, të ndara nëpër 19 famulli.⁶⁴ Pas bashkimit në një rang me arqipeshkvinë e Tivarit më 1867, ipushkvia e Shkodrës mori kështu titullin e arqipeshkvisë. Pasi arqipeshkvia e Tivarit u shkëput më 1886 dhe u shpall përgjegjëse vetëm për Principatën e Malit të Zi, atëherë Shkodra, prej 22 prillit 1887, mundi të ruante titullin e arqipeshkvisë bashkë me dioqezat e saj shufragane shqiptare të Lezhës, Pultit dhe Sapës, duke formuar Provincën Kishtare të Shqipërisë Veriore.⁶⁵ Sipas relacioneve të arqipeshkvit të ri, Pasquale Guerini, në vitin 1887 jetonin në këtë arqipeshkvi 25.870 katolikë, të ndarë në 24 famulli, që mbikqyreshin prej 24 priftërinjve dioqezanë, 11 françeskanë dhe 9 jezuitë.⁶⁶ Më 1890 zëvendëskonsulli austro-hungarez në Prizren, Pisko, njofton se në arqipeshkvinë e Shkodrës jetonin 36.396 katolikë, 25.904 myslimanë dhe 1.460 ortodoksë, të ndarë në 25 famulli: 17 syresh i drejtonin priftërinj dioqezanë, ndërsa 8 famullitë e Kastratit mbikqyreshin si zonë misionare vetëm prej fretërve françeskanë, duke u mbështetur financiarisht prej Vjenës.⁶⁷

Dioqeza shufragane e Lezhës daton prej Antikitetit të vonë dhe në historinë e saj të gjatë ka qenë nën jurisdiksionin e metropolive të ndryshme.⁶⁸ Nga pikëpamja politike ajo kishte të njëjtin fat si dioqezat e tjera shqiptaro-veriore dhe më 1506 hyri përfundimisht nën sundimin osman. Kjo çoi në një dobësim të ndjeshëm të pranisë katolike, ngaqë një pjesë e popullsisë pranoi islamin. Pas rigjallërimit në shek. XVII, selia e ipushkvit të Lezhës mbulohej kryesisht nga misionarë italianë. Në vitin 1785, në ipushkvinë e Lezhës kishte 19.404 katolikë, të ndarë në 24 famulli dhe që administroheshin prej klerit dioqezan.⁶⁹ Në vitin 1890 numri i katolikëve u ul në 11.678, kurse ai i famullive në 15.⁷⁰ Në fund të epokës turke (1912) Lezha ishte ipushkvia e vetme në Shqipëri ku shumica e banorëve ishin katolikë.⁷¹ Ipushkvia e Pultit u themelua në shek. IX. Prej 1340 deri 1520 përmenden dy ipushkvi me këtë emër: *Pulati Maior* dhe *Pulati Minor*.

Në fillim kjo ipushkvi varej prej metropolisë së Durrësit dhe nga viti

64 P. BARTL, *Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte*, 25.

65 RITZER-SEFRIN, *Hierarchia catholica* VIII, 106, 505.

66 APF, *Albania*, vol 43, fol. 783; RITZER-SEFRIN, *Hierarchia catholica* VIII, 505.

67 E. DEUSCH, 93,106.

68 P. BARTL, *Albania Sacra* 1, 13-16.

69 R. RITZER - P. SEFRIN (Hg.), *Hierarchia catholica medii et recentioris aevi* VI, Padua 1958,76.

70 E. DEUSCH, 95-96.

71 BARTL, *Albania Sacra* 1, 18-19.

1089 prej asaj të Tivarit. Pulti ndodhet në Alpet Shqiptare, në veri të Shkodrës, dhe asokohe ishte reduktuar kryesisht në fiset malore të dinastisë Dukagjini.⁷² Kjo zonë ra relativisht vonë nën sundim osman. Sipas relacionit baritor të vitit 1703, në ipeshkvinë e Pultit kishte 3.000 katolikë, të cilët udhëhiqeshin shpirtërisht prej katër misionarëve françeskanë.⁷³ Deri në 1835 numri i katolikëve u rrit në 9.511, të cilët ishin ndarë në 9 famulli dhe mbikqyreshin po prej françeskanëve.⁷⁴ Më 1890 kishte 10 famulli me 14.213 katolikë.⁷⁵ Për shkak të terrenit të varfër dhe klimës së ashpër, Pulti konsiderohej si ipeshkvia më e varfër e Shqipërisë.⁷⁶

Dioqeza e tretë shufragane, Sapa, është relativisht më e re në moshë. Ajo u themelua prej Papës Aleksandri II dhe bënte pjesë në Provincën Kishtare të Tivarit. Ajo shtrihej përgjatë rrjedhës së poshtme të Drinit, në juglindje të Shkodrës. Në fund të shek. XVII, në zonat malore dhe në ultësi ishte islamizuar një e pesta e banorëve. Në shek. XVI-XVII Sapa u bashkua me dioqezën fqinje të Sardës.⁷⁷ Në vitin 1706 ipeshkvia numëronte 9.000 katolikë, që mbikqyreshin vetëm prej një misionari.⁷⁸ Numri i besimtarëve erdhi në rritje dhe në vitin 1876 ipeshkvia numëronte 17.270 katolikë, të ndarë në 26 famulli dhe të mbikqyrur nga 21 pritërinj.⁷⁹ Në vitin 1890 diplomatët austro-hungarezë gjetën në ipeshkvinë e Sapës 19.828 katolikë dhe 25 famulli. Në territorin e ipeshkvisë banonin vetëm 1.310 myslimanë.⁸⁰

Në Provincën Kishtare të Shqipërisë hynte edhe Abacia e Mirditës e Shën Aleksandrit në Orosh, në lumin Mat, e cila shtrihej midis dioqezave të Lezhës dhe Sapës. Dikur ajo kishte qenë një abaci benediktine, e braktisur prej murgjve qysh përpara pushtimit osman.⁸¹ Më vonë titullin e Abatit të Nderit e morën famullitarët e Oroshit të cilët si *abas nullius* ishin nën

72 H.KALESHE, *Dukagjini*, in: BLGS 1,444-446.

73 R. RITZER - P. SEFRIN (Hg.), *Hierarchia catholica medii et recentioris aevi* V, Padua 1952,325.

74 R. RITZER- P. SEFRIN (Hg.), *Hierarchia catholica medii et recentioris aevi* VII, Padua 1868, 315.

75 E. DEUSCH, 96-97.

76 ID., 108-109.

77 GAUCHAT, *Hierarchia catholica* IV, 305; P. BARTL, *Das Bistum Sappa-Sarda in Nordalbanien nach einem Bericht aus dem Vatikanischen Archiv* (ca. 1750), in: SOF 25 (1966) 27-37.

78 RITZER -SEFRIN, *Hierarchia catholica* VIII, 345.

79 ID., 500.

80 E. DEUSCH, 94.

81 F. CORDIGNANO, *Antichi monasteri benedettini e loro benemerienze sociali in Albania*, in: *Civiltà Cattolica* 80/2 (1929) 399-413; 80/3 (1929) 13-28; 80/4(1929) 226-239.

juridiksionin e Selisë së Shenjtë.⁸² Abacia e Mirditës u nda më 1888 prej dioqezës së Lezhës dhe në 1890 përfshinte shtatë famulli me 11.978 katolikë.⁸³

2.1.3. Arqipeshkvia Durrës/ Dyrrachion

Arqipeshkvia e Durrësit, Dyrrachion i vjetër, ishte një themelim i moçëm që me gjasë daton nga koha apostolike. “Sipas përfytyrimeve romake” ajo gjendej në Provincën Kishtare të Rumelisë dhe përfshinte Shqipërinë e mesme në jug të lumit Matja, më tej Shqipërinë e jugut dhe shtrihej në të gjithë Epirin, deri në Gjirin e Artës në Greqinë e sotme. Për rrjedhojë, Durrësi për nga sipërfaqja ishte arqipeshkvia më e madhe e Shqipërisë. Në shek. VIII Durrësi përbënte një ledh mbrojtës të interesave bizantine e më pas atyre ortodokse në pjesën jugore të Adriatikut lindor. Prej shek. XII Durrësi ra gjithnjë e më shumë nën ndikimin perëndimor. Në shek. XIII, në Durrës-Krujë krahas metropolitit ortodoks kishte selinë edhe një ipeshkëv katolik, që varej direkt nga Roma. Pas pushtimit nga turqit, në vitin 1501, organizimi kishtar katolik brenda arqipeshkvisë u shpërbë krejtësisht dhe u dorëzuan dioqezat shufragane: *Albanensis*, *Canoviensis*, *Bendensis* dhe *Lissensis*. Pjesa më e madhe e popullsisë kaloi në islam.⁸⁴ Arqipeshkvi i fundit latin, Francesco Quirini, shkoi në Romë ku edhe vdiq. Në vijim, Roma u kufizua vetëm me emërimin e arqipeshkvijve titullarë, sepse rrallëherë autoritet osmane u lejonin ipeshkvijve katolikë të ushtronin detyrën. Më 1640, arqipeshkëv i Durrësit u emërua më në fund Mark Scura.⁸⁵

Këtej e tutje ipeshkvia do të përfaqësohej rregullisht. Selia ipeshkvnore gjendej në Manastirin Françeskan të Kurbinit, në veri të Durrësit. Më 1852 selia u zhvendos në fshatin Delbinisht, afër Durrësit, ku edhe mbeti deri në fund të periudhës turke.⁸⁶ Gjatë Luftës së Madhe Turke (1683-1699) një numër i madh katolikësh kaluan në fenë islame dhe në ortodoksi. Në vitin 1702 numëroheshin vetëm 1.047 shtëpi katolike dhe 8.252 besimtarë.⁸⁷ Në 1847, në 18 famulli jetonin 8.319 katolikë të mbikqyrur prej 6 priftërinjsh dioqezanë dhe 9 rregulltarësh. Ipeshkvia kishte 9

82 P. BARTL, *Albania Sacra* 1, 56-60.

83 P. BARTL, *Die Abtei des hl. Alexander in der Mirdita nach den Berichten ihres Abtes Prenk Doçi aus den Jahren 1888-1896*, in: *Münchener Zeitschrift für Balkankunde* 10/11 (1996) 7-83; E. DEUSCH, 97.

84 P. BARTL, *Die katholische Kirche im Mittelalter*, 54-55.

85 Nën juridiksionin formal të tij ishin formalisht dioqezat shufragane të Bendensis, Croiensis, Alexiensis, Conaviensis und Stephanensis, të cilat ishin shpërbërë nga turqit. Khrr. P. GAUCHAT, *Hierarchia catholica* IV, 179.

86 P. BARTL, *Albania sacra. Geistliche Visitationsberichte aus Albanien. 2: Erzdiözese Durazzo*, Wiesbaden 2011, 11.

87 P. BARTL, *Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte*, 98.

seminaristë dhe asnjë dioqezë shufragane.⁸⁸ Në vitin 1890 situata e Kishës dukej shumë më e përmirësuar. Në territorin e ipeshkvisë jetonin 11.278 katolikë, 46.000 ortodoksë dhe 95.000 myslimanë. Nga 23 famulli, gjashtë administroheshin prej françeskanëve dhe 17 prej klerit shekullar. Në vitin 1912 numri i katolikëve ishte rritur deri në rreth 14.000, të shpërndarë në 24 famulli.⁸⁹ Sipas vlerësimit të zëvendëskonsullit austro-hungarez në Prizren, Pisko, në krejt Provincën Kishtare të Shqipërisë në 1890-ën jetonin rreth 106.235 katolikë. Gjithsej kishte 91 famulli, që mbikqyreshin kryesisht prej priftërinjve dioqezanë dhe pjesërisht prej atyre françeskanë dhe jezuitë. Në territorin e kësaj province kishtare jetonin shumica e katolikëve shqiptarë.⁹⁰

2.1.4. Ipeshkvia e Shkupit

Edhe ipeshkvia e Shkupit ka qenë një themelim i hershëm dhe qysh prej Mesjetës pjesë e së ashtuquajturës Provincë Kishtare e Serbisë. Gjithnjë ka qenë nën varësinë direkte të Romës. Shkupi ra qysh në vitin 1392 nën sundim osman. Për shumë kohë osmanët nuk i lejuan ipeshkvijtë e emëruar të kryenin detyrën. Këtyre u duhej ose të dorëhiqeshin ose të rrinin jashtë vendit. Më 1656, nën ipeshkvin Andreas Bogdani, Shkupi u ngrit në rangun e një arqipeshkvie.⁹¹ Arqipeshkvin Andrea e pasoi nipi i tij, Pjetër Bogdani.⁹² Në këtë kohë shpërtheu Lufta e Madhe Turke. Ipeshkvia përjetoi një katastrofë të vërtetë: Selia e ipeshkvit u shkrumbua nga turqit, kishat u shkatërruan ose u shndërruan në xhami, priftërinjtë u vranë ose u dëbuan, besimtarët u kthyen në fenë islame ose në atë ortodokse. Shumë të tjerë morën arratinë drejt viseve të Perandorisë dhe të Venedikut. Arqipeshkvijtë e zhvendosën selinë në oazin kroat Janjevo pranë Prishtinës dhe qëndruan këtu deri më 1821.⁹³ Më 1702 arqipeshkvia kishte shumë pak katolikë dhe veç 11 famulli, 4 prej të cilave ndodheshin në Shqipëri.⁹⁴ Në shek. XIX u përmirësua situata e Kishës, ndonëse numri i famullive u zvogëlua. Kështu p.sh. në vitin 1865 kishte 6 famulli, 6 priftërinj vendas, 7 misionarë të huaj,

88 APF, *Albania*, vol. 39, fol. 416-417; RITZLER- SEFRIN, *Hierarchia catholica* VIII, 25; E. DEUSCH, 98.

89 APF, *Albania*, vol. 292, fol. 288rv; Z. PIËTA, *Hierarchia catholica medii et recentioris aevi* IX, Padua 2002, 163.

90 E. DEUSCH, 93-99.

91 P. GACHAT, *Hierarchia catholica* IV, 357.

92 R. RITZLER – P. SEFRIN (Hg.), *Hierarchia Catholica medii et recentioris aevi* V, Padua 1952, 346.

93 B. PANDŽIĆ, *L'Opera della S. Congregazione per le popolazioni della Penisola Balcanica centrale*, in: J. METZLER (Hg.), *Sacrae Congregationis de Propaganda Fide memoria rerum* II, Rom 1973, 706-721, këtu 713-714; E. DEUSCH, 154.

94 P. BARTL (Hg.), *Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte*, 128-140.

4 shkolla katolike dhe 10.112 katolikë. Më 1889 numri i katolikëve u rrit deri në 15.226,⁹⁵ të cilët në vitin 1914 u ndanë në 12 famulli.⁹⁶ Katër prej këtyre famullive mbikqyreshin prej françeskanëve. Arqipeshkvi i fundit i Shkupit, Lazar Mjeda (1909-1921), u detyrua prej serbëve të arratisë nga Shkupi dhe më 1921 u emërua arqipeshkëv i Shkodrës.⁹⁷ Për rrjedhojë, si pjesë e shtetit të ri, Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, Shkupi në vitin 1921 e humbi statusin e një arqipeshkvie.⁹⁸

3. Aktiviteti misionar si fryt i zellit të sinodeve shqiptare dhe koncileve plenare

3.1. Aktiviteti misionar si fryt i sinodeve shqiptare

Në pamje të parë, gjurmët e aktivitetit misionar, përsa i përket praktikës së sinodeve të Kishës katolike në dioqezat shqiptare, as janë të dallueshme, as mund të përkufizohen. Historia e tyre nuk është hulumtuar dhe zbardhur, as në kuadër të historisë misionare, as të historisë së koncileve.⁹⁹ Por sot dimë se, më 1462, në periudhën paraosmane, në Mat të Shqipërisë qendrore u mbajt një sinod provincial ose kombëtar. Pjesëmarrësit e sinodit janë takuar me siguri në një prej manastireve të shumtë benediktine në Matit, ndër të cilët shquhej ai i Shën Aleksandrit.¹⁰⁰ Sinodi pati për qëllim parësor të bashkonte mes veti dhe të forconte qëndresën historike të katolikëve shqiptarë kundër depërtimit osman në Shqipëri. Sinodi u thirr dhe u mbajt prej arqipeshkvit guximtar të Durrësit, Pal Ëngjëlli¹⁰¹, dhe duhet të jepte direktivat kryesore për jetën e besimtarëve në gjendje lufte. Direktivat janë ruajtur në gjuhën shqipe. Formula e Pagëzimit e rekomanduar prej arqipeshkvit përbën njëkohësisht dëshminë e parë me shkrim të gjuhës shqipe.¹⁰² Me anë të kësaj mase, arqipeshkvi donte të përfshinte shtresat

95 E. DEUSCH, 98.

96 ID., 100-101; P. BARTL, *Geistliche Visitationsberichte als Quellen zur albanischen Volks- und Kirchengeschichte. Die Erzdiözese Skopje*, in: Th. KAHL, I. MAKŠUTI, A. RAMAJ (Hgg.), *Die Albaner in der Republik Makedonien. Fakten, Analysen, Meinungen zur interethnischen Koexistenz*, Wien-Berlin 2006, 21-37.

97 PIËTA, *Hierarchia catholica* IX, 333; PETERS, 40.

98 PIËTA, *Hierarchia catholica* IX, 333.

99 Shkrimet mbi koncilet dhe sinodet shqiptare janë te shkurtra dhe të pamjaftueshme. Kh. P. RICHARD, *Albania*, in: DGHE III, 721-722; G. PALAZZINI, *Merchigne*, in: P. PALAZZINI III, Roma 1965, 91-92; P.V. MALAJ, *Concilio nazionale albanese del 1703* (Dissertation Rom 1972). Z. GASHI, *Kuvendi i Arbënit 1703*, Pristina 2003.

100 ŠUFFLAY, 272.

101 Kh. O. J. SCHMITT, *Paul Angelus, Erzbischof von Durazzo und seine Bedeutung für den Türkenkampf Skenderbergs*, in: *Bollettino dell'Istituto Ellenico di studi bizantini e postbizantini*, 30 (2000), 127-161.

102 Bëhet fjalë për Formulën e Pagëzimit: *Un'te paghesont' pr'emenit t'Atit e t'Birit e t'Spirit Senit.* (= Ich taufe dich im Namen des Vaters und des Sohnes und des Heiligen Geistes.)

e gjera të popullit në përpjekjet për të ringritur Kishën. I pari sinod i njohur prej epokës osmane është sinodi dioqezan i Tivarit, i vitit 1625, që u thirr prej arqipeshkvit Pjetër Massarechi (1624-1634) dhe që vendosi dymbëdhjetë kanonet.¹⁰³ Sinodi i dytë gjatë periudhës osmane u mbajt më 10 dhjetor 1674 në Spič (Spizza), një gji në veriperëndim të Tivarit, nën drejtimin e arqipeshkvit të Tivarit Andrea Zmajević (1671-1694), në kishën e Shën Teklës.¹⁰⁴ Me shumë gjasa pjesëmarrësit kanë diskutuar në gjuhët e tyre të zakonshme, ndërsa aktet përfundimtare u përpiluan në gjuhën kroate. Megjithëse këto akte origjinale kanë humbur, ato janë të ruajtura në një përkthim latinisht të 1720^{-ës} dhe u botuan në *Illyricum Sacrum* nga Coleti.¹⁰⁵ Aktet në fjalë ndahen, në përputhje me udhëzimet e *Congregatio de Propaganda*, në dymbëdhjetë kapituj dhe bëjnë fjalë për iniciativat e Kongregacionit për Kishën në Shqipëri. Nisur nga zelli e këmbëngulja e njohur e arqipeshkvit Zmajević, duhet pranuar se ai ia doli të përhapte mes klerit vendimet më të rëndësishme të sinodit. Shumë interesante është njëkohësisht që ky sinod u mbajt në një kishë të përdorur prej katolikëve e ortodoksëve njëherësh dhe se pajtorja e kishës, Shën Tekla, nderohej prej të dyja palëve. Edhe fakti tjetër që, arqipeshkvi Zmajević kishte gjetur një vendstrehim të sigurtë tek ortodoksët e fisit Paštrović, flet për marrëdhëniet e mira mes katolikëve dhe ortodoksëve në këtë kohë dhe se, të dyja palët kërcënoheshin prej të njëjtit rrezik turk.¹⁰⁶

3.2. Aktiviteti misionar si angazhim i koncileve plenare

3.2.1. Koncili i parë plenar shqiptar 1703

Pasardhësi i dytë i arqipeshkvit të sipërpërmendur Andrija, ishte nipi i tij Vinçenc Zmajević (1670-1745). Si arqipeshkëv i Tivarit ai e drejtoi arqipeshkvinë prej 1701 deri në 1713. Më pas, më 1713 Zmajević u emërua arqipeshkëv në Zadar (Zara) dhe e drejtoi këtë arqipeshkvi të rëndësishme

Formula e Pagëzimit u gjend në një letër pastorale latinisht, të cilën e kishte hartuar arqipeshkvi pas vizitës baritore në një kishë të Matjas. Letra mban datën 8 nëntor 1462. Dokumenti me Formulën e Pagëzimit ruhet në Biblioteca Medicea Laurenziana në Firence dhe u zbulua vetëm më 1915 nga historian rumun Nicolae Iorga. Khrr.: N. JORGA, *Notes et extraites per servir à l'histoire des croisades au XV siècle*. Bukarest 1915, 195; O. J. SCHMITT, *Das venezianische Albanien*, 586.

103 J. COLETI, *Illyricum sacrum. Ecclesia Diocletana, Antibarensis, Dyrrhachiensis et Sirmiensis* VI, Venetiis 1817, 123. Gjurmë të sinodit janë ruajtur edhe në dekretin e Kongregacionit të Selisë së Shenjtë të datës 6 shtator 1625.

104 J. COLETI, *Illyricum sacrum* VII, 133-139; I. MARKOVIĆ, *Dukljansko-barska metropolija*, Zagreb 1902, 143-147; P. BUTORAC, *Zmajević: ogledi*, Zagreb 1928, 3-14; L. ĆORALIĆ, *Prilog životopisu nadbiskupa Andrije Zmajevića (1671.-1694.)*, in: *Croatia christiana periodica* 53 (2004), 203-220, këtu 209.

105 J. COLETI, *Illyricum sacrum* VII, 133-139.

106 MARKOVIĆ, 143-147.

deri në 1745.¹⁰⁷ Arqipeshkvi Zmajević është pa dyshim autoriteti më i madh dhe më me influencë në gjysmën e parë të shek. XVIII në jug të Adriatikut lindor. Ai ishte nxënës i *Collegio Urbano* në Romë, abat i Shën Gjergjit në Perast dhe famullitar po aty. Pak pas emërimit të tij si ipeshkëv, më 8 korrik ai u dërgua prej Kongregacionit të Propagandës si vizitator apostolik në Shqipëri, Serbi dhe Maqedoni.¹⁰⁸ Brenda dy vitesh ai vizitoi të gjitha famullitë në territorin e arqipeshkvisë së Tivarit, Durrësit dhe Shkupit, çka përkon sot me Shqipërinë, Maqedoninë, Kosovën dhe Malin e Zi. Vizitat baritore të tij u zgjeruan më vonë edhe në Bullgari dhe Bosnje.¹⁰⁹ Me vizitat e tij, Zmajević shfrytëzoi mundësinë që ishte krijuar nga dobësimi i Perandorisë Osmane, pasi kjo ishte detyruar të nënshkruante Paqen e Karlowitz-it më 1699, në përfundim të Luftës së Madhe Turke.¹¹⁰ Ai gjithashtu shfrytëzoi si momentin e favorshëm politik, “inspirante Deo mitiora Turcis consilia”, ashtu edhe miqësinë me pashain e Shkodrës, i cili i mundësoi që në kishën e Gjon Pagëzorit në Mërqi, në selinë e ipeshkvit të Lezhës, të thërriste dhe të mbante të parin Koncil kombëtar, në të dielën e dytë pas Epifanisë së vitit 1703.¹¹¹

Koncili faktikisht filloi të dielën e dytë pas Epifanisë së vitit 1703 dhe u mbledh prej 14-16 janar të 1703. Krahës Zmajević, në rolin e drejtuesit, duke u bazuar tek firmat e hedhura në koncil morën pjesë edhe: Petrus Zumi, arqipeshkëv i Durrësit,¹¹² Petrus Karadžić, arqipeshkëv i zgjedhur i Shkupit,¹¹³ Georgius Teodori, ipeshkëv i Sapës,¹¹⁴ Nicolaus Vladagni, ipeshkëv i Lezhës,¹¹⁵ Antonius Babbi, arqipeshkëv i zgjedhur i Shkodrës,¹¹⁶ Marinus Gini, arqipeshkëv i zgjedhur i Pultit,¹¹⁷ P. Aegidius de Armento, prefekt apostolik i misionit në Shqipëri, P. Franciscus Maria a Lycio,

107 RITZLER-SEFRIN, *Hierarchia Catholica* V, 88.

108 *Ibid.*

109 Njoftimi i vizitës baritore të datës 6 maj 1702. Shih: P. BARTL (Hg.), *Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte*, 192.

110 M. MOLNÁR, *Der Friede von Karlowitz und das Osmanische Reich*, in: A. STROHMEYER – N. SPANNENBERGER (Hgg.), *Frieden und Konfliktmanagement in interkulturellen Räumen. Das Osmanische Reich und die Habsburgermonarchie in der Frühen Neuzeit*, Stuttgart 2013, 197–220.

111 Ftesa me shkrim për koncilin u nis më 2 dhjetor 1702 nga manastiri i Kurbinit nënshkruar prej arqipeshkvit dhe vizitatorit Zmajević dhe sekretarit të tij, fratit domenikan Raimundus Gallani. Khros. *Concilium Provinciale sive Nationale Albanum habitum Anno MDCCIII*. Clemente XI. Pont. Max. Albano. Romae 1706, 1-3.

112 RITZLER-SEFRIN, *Hierarchia catholica* V, 190.

113 Idem, 347.

114 Idem, 344.

115 Idem, 78.

116 Idem, 347.

117 Idem, 325.

prefekt apostolik i misionit në Maqedoni dhe P. Martinus a Gionima, provinciali françeskan në Shqipëri. Shënohet se, në sinod morën pjesë 43 klerikë dhe 200 besimtarë.¹¹⁸ Në verën e 1703-it, aktet e koncilit u dërguan në Romë me lutjen që ato të verifikoheshin dhe të shtypeshin sa më shpejt. Kongregacioni i Propagandës i verifikoi aktet me anë të dy kardinalëve, të cilët në përfundim dhanë pëlqimin për shtypjen e tyre. Pas kësaj Kongregacioni urdhëroi botimin dygjuhësh të akteve, latinisht dhe shqip, botim që doli nga shtypi në një vëllim të vetëm më 1706, nën Pontifikatin e Papës Klement XI.¹¹⁹ Akteve të koncilit iu bashkangjiten edhe katër dokumente të rëndësishme për Kishën në Shqipërinë e shek. XVII.¹²⁰ Dekretet e koncilit gjetën një rezonancë të madhe në rrethet kishtarë të Romës dhe më vonë Papa Benedikti XIV do t'i citonte dy herë në veprat e tij.¹²¹

Aktet e koncilit përbëhen nga katër pjesë. Pjesa e parë, e ndarë në 10 kapituj, është padyshim me tepër interes për ne, pasi merret me gjendjen specifike të katolikëve shqiptarë. Bëhet fjalë konkretisht për problemet e rëndësishme të Kishës dhe detyrat e saj misionare në Shqipërinë e sunduar nga osmanët. Kështu p.sh., kapitulli i parë na jep në mënyrë të zgjeruar shpalljen e besimit, përdorimi i së cilës do të ishte i detyrueshëm për priftërinjtë në sinodet dioqezane që do të vijonin pas këtij koncili kombëtar; kapitulli i dytë trajton rastin e braktisjes së besimit ose të konvertimit në fenë islame. Për të shmangur haraçin, shumë të krishterë do të jetonin së jashtmi si myslimanë, kurse në të vërtetë mbetën të krishterë të fshehur (kriptokatolikë ose laramanë). Për të ardhmen u vendos që, të larguarve nga Kisha barinjtë shpirtërorë do tua jepnin sakramentet vetëm nëse këta, pas betimit, do të pranonin sërish publikisht krishtërimin ("quibus cura animarum incumbit, serio injungimus, ne imposterum tales Apostatas ad Sacramentorum participationem recipiant, nisi, facta prius abjuratione, publice se more Christianorum gerant")¹²²; kapitulli i tretë

118 *Concilium Provinciale sive Nationale Albanum*, 94-95.

119 *Ibidem*, IV.

120 Bëhet fjalë për: 1. një dokument të 14 dhjetorit 1638 mbi ndarjen kufitare mes dioqezës së Lezhës dhe asaj të Durrësit; 2. një dokument të 20 dhjetorit 1638 nga rezidenca ipeshkvnore e Sapës, ku rregullohen grindjet për kufizimet kufitare mes dioqezave të Sapës dhe Lezhës; 3. një dekret i Selisë së Shenjtë i datës 4 maj 1641, që i ndalon ipeshkvit të Sapës dhënien e sakramentit të pagëzimit të rinjve myslimanë; 4. Një dokument i Kongregacionit të Inkuizicionit, i datës 6 shtator 1625, që i ndalon arqipeshkvit të Tivarit të pagëzojë fëmijë turq, për t'i mbrojtur ata eventualisht nga sëmundjet. Khrrs. *Concilium Provinciale sive Nationale Albanum*, 31-32, 95-107.

121 *De synodo diocesana*, liber VII, c.9, Prati 1844 si edhe enciklikën "Inter omnigenas calamitates" e 2 shkurtit 1744 in: *Concilium Provinciale sive Nationale Albanum*, Romae 1803, 121-135.

122 *Concilium Provinciale sive Nationale Albanum*, 13.

merret me sjelljen e atyre të krishterëve, që paraqesnin një trajtë të butë të kriptokrishterimit ose të laramanizmit. Ndonëse nuk e kishin braktisur besimin, këta njerëz konsumonin mish në publik gjatë agjërimit dhe duke mbajtur emra myslimanë prezantoheshin së jashtmi si “turq”. Edhe këtyre u refuzohej marrja e sakramendeve (“Deficientes quidem in publica, et externa Fidei professione, merito ab externa, et visibili Sacramentorum communione excludi debent, donec ad meliorem frugem redeant, et Fidem Christi publice profiteantur, quoties feret occasio”)¹²³; kapitulli i katërt trajton dallimet e jashtme mes të krishterëve dhe myslimanëve dhe ua ndalon të krishterëve që t’u përshtaten myslimanëve e të mohojnë besimin publikisht; kapitulli i pestë vendosi celebrimin e doktrinës së krishterë çdo të dielë, para ose pas meshës, siç e kishte përcaktuar Konkili i Trentit, sepse njohja e të vërtetës së krishterë përbën themelin e jetës së besimtarëve; kapitulli i gjashtë i detyron famullitarët që në të gjitha ditët e festave të mbajnë predikime, që drejtohen kryesisht kundër braktisjes së besimit; kapitulli i shtatë thekson mirë faktin, që festat kishore duheshin celebruar denjësisht, t’i përmbaheshin kalendarit romak dhe t’i shpalleshin popullit në kohën e duhur; kapitulli i tetë vendosi që ditët e agjërimit të respektoheshin me përpikmëri dhe të mos konsumohej mishi as të premteve, as të shtunave; kapitulli i nëntë nënvizon edhe njëherë se, të gjithë janë të detyruar të agjërojnë përpara Pashkëve, kurse kapitulli dhjetë lufton betimin e rremë (“juramentum falsum”) dhe u refuzon besëthyesve dhënien e sakramendeve¹²⁴. Në pjesën e dytë (kap. 1-9) bëhet fjalë për sakramendet, shtatë burimet, prej të cilëve rrjedh uji i mëshirës së Krishtit dhe ku urdhërohet që ndarja e sakramendeve të bëhet pikë për pikë sipas *Rituale Romanum*¹²⁵. Në kapitullin e dytë theksohet fakti që, pagëzimi sipas formulës së dhënë duhej bërë në kishën famullitare dhe jo nëpër shtëpi private, si dhe nuk lejohej të përsëritej. Pagëzimi duhej bërë nga prifti dhe vetëm në rastet e rrezikut të jetës prej një besimtari. Konkili e përcaktoi saktë ritualin pagëzor: tri herë duhet derdhur ujë në formën e kryqit duke thënë njëkohësisht fjalët pagëzuese: “N., unë të pagëzoj në emër të + Atit dhe të + Birit dhe të Shpirtit të + Shenjtë”. Të gjithë fëmijët duhen pagëzuar me këtë formulë. Përveç kësaj, janë etërit e sinodit që vendosin se, fëmijët duhen pagëzuar në kishë në praninë e dy dëshmitarëve (kumbarë) dhe se, në çdo kishë duhet ndërtuar një pagëzimore, pa përfillur rrezikun e vandalizmit turk. U vendos që emrat e të pagëzuarve dhe të kumbarëve duhet të shënoheshin prej meshtarit në një libër (“in statuto codice adnotentur”)¹²⁶.

123 Ibidem, 14-15.

124 Ibidem, 24-25.

125 Ibidem, 25-26.

126 Ibidem, 26-30.

Koncili shqyrton edhe çështjen nëse, në rast sëmundjeje, pagëzimi mund t'u bëhej edhe fëmijëve turq, si një pagëzim i rremë ("An Infans datus a Turcis, ut baptizetur, ut liberetur a foetore, possit ficto baptizari"). Pas marrjes në dorëzim të dekreteve të Selisë së Shenjtë, të 6 shtatorit 1625 dhe 4 majit 1641, përgjigja e dhënë ishte negative, sepse pagëzimi konsiderohej si porta e të gjitha sakramendeve dhe si shpallje e besimit. Prandaj pagëzimi i rremë nuk lejohej në asnjë rrethanë ("Respondit negative; quia baptisma est janua omnium Sacramentorum, ac protestatio Fidei, nec ullo modo fingi potest").¹²⁷ Në kapitullin e tretë bëhet fjalë për sakramendin e krezmimit, i cili i rezervohet ipeshkvit dhe që zakonisht ndahet gjatë vizitave ipeshkvnore, pas një njoftimi paraprak. Për krezmimin Koncili përcakton si moshën minimale 7 vjeç dhe se kumbara duhet të jetë krezmuar vetë më parë. Kështu që myslimanët dhe ortodoksët janë të përjashtuar prej krezmimit. Po sipas Koncilit, nëse i pagëzuari ishte i rritur atëherë më parë ai duhej të rrëfehej ose së paku të pendohej për mëkatet e veta. Me anë të krezmimit me kumbarën krijohej një afri shpirtërore, për të cilën vlejnë të njëjtat rregulla si tek pagëzimi. Famullitarët ishin të detyruar të shënonin emrin e të krezmuarit dhe të kumbarës përkatës. Ngaqë shumë prej këtyre nuk dinin të shkruanin, duhet të kujdeseshin vetë arqipeshkvijtë dhe ipeshkvijtë që kjo gjë të kryhej ("ipsi eorum officio propria opera, pastoralis consulant solitudine, ut cauta provisione revocatur ad praxim, quod pernicioza ignorantia intermissum est ad damnum")¹²⁸. Në kapitullin e katërt trajtohet sakramendi i rrëfimit ("poenitentia"). Fillimisht Koncili vendosi që të gjithë priftërinjtë rrëfyes të kishin arsim fillor, të mësonin përmendësh formulën e faljes së mëkateve sipas *Rituale Romanum*, t'u mësonin drejt pendestarëve shqyrtimin e ndërgjegjes, dhe t'u bënin katekizëm lidhur me urdhëresat hyjnore, udhëzimet kishtare dhe mëkatet mortare. Përveç kësaj, famullitarët kishin për detyrë që të nxisnin drejt rrëfimit tërë ata besimtarë që kishin arritur moshën madhore, sepse në këtë kohë në Shqipëri nuk shkonte kush për t'u rrëfyer pa mbushur 16 vjeç, madje edhe në moshë më madhore. Koncili e përmbyll këtë kapitull duke ua ndaluar priftërinjtë rrëfyes pretendimin për çdolloj tarife kundrejt dëgjësës së rrëfimit, për të mos u njollosur me turpin e simonisë ("ut gratis dent, quod gratis acceperunt, nihilique praetendere audeant pro audita, vel audienda confessione, ne simonica labe polluantur, quae in perditionis filios pestilentissime derivatur")¹²⁹. Në kapitullin e pestë Koncili u kërkon të gjithë besimtarëve që pas të rrëfyerit të marrin sakramendin e kungimit, të paktën një herë në vit. Kush nuk i përmbahej kësaj urdhërese, i sinjalizohej ipeshkvit dhe i nështrohej censurave kishtare. Ngaqë rreziku i sulmeve

127 Ibidem, 31-32.

128 Ibidem, 32-34.

129 Ibidem, 34-37.

islamike ishte tepër i madh, klerikëve u lejohej që të ruanin në shtëpi sendet më të shenjta, si dhe të shkonin e të ndanin sakramendet në shtratin e të sëmurëve, edhe duke mbajtur një veshje të zakonshme, por gjithnjë nën shoqërimin e një besimtari. Përtej kësaj, klerikëve u kërkohet që t'ua jepnin kungimin të sëmurit në bashkësinë e krishterë sipas udhëzimeve të *Rituale Romanum*¹³⁰. Kapitulli i gjashtë trajton vajimin e të sëmurëve ("extrema unctio"). Klerikëve u rekomandohet që vajimin e të sëmurëve rëndë të mos e vonojnë aq sa i sëmuri të kalojë në gjendje të pavetëdijshme. Me këtë synohej të frenohej bestytia e përhapur tashmë se, vajimi i të sëmurit e përshpejtonte vdekjen¹³¹. Kapitulli tjetër i rëndësishëm, i shtati, flet për sakramendin e shugurimit ("Sacramentum ordinis"), ku disa nga mesi i besimtarëve përzgjidhen veçmas. Ishte detyrë e ipeshkvijve që të mos lejonin shugurimin e kandidatëve të papërshtatshëm dhe të pashkolluar ("ut in manuum impositione cautius agant, et ad Sacerdotale ministerium idoneos tantum eligents, calamitatibus, quae in necem Christiani Populi grassantur, provide occurant")¹³². Kësisoj për ipeshkvijtë u forcuan rregullat tridentine mbi kushtet shpirtërore e morale të kandidatëve meshtarë. Me mjetet e Kongregacionit të Propagandës në Romë duheshin financuar shkolla në Shqipëri, prej të cilave ipeshkvijtë do të mund të zgjidhnin kandidatët e duhur¹³³.

Qëllimi i sakramendit të kurorës së martesës ("sacramentum matrimonii") trajtohet në kapitullin e tetë dhe Koncili mori vendim që, dekretet martesore të Koncilit të Trentit të zbatoheshin në të gjitha dioqezat e Shqipërisë dhe të Serbisë. Në këtë mënyrë, lidhjet e fshehta martesore në malet e Shqipërisë bëheshin të pavlefshme dhe joligjore. Klerikëve u rikujtohej se, një kurorë martesore paraprihej nga rrëfimi dhe komunioni dhe se ajo lidhej në prani të dëshmitarëve dhe pa asnjë lloj shtërngimi nga jashtë. Koncili shprehej kundër praktikës se kurora martesore duhej lidhur në kishë vetëm pasi gruaja të kishte lindur një djalë¹³⁴. Kapitulli i nëntë drejtohet kundër abuzimeve që ishin të përhapura ndër fiset malësore shqiptare: konkubinati shumëvjeçar dhe martesë të detyruara me pjesëtarë të besimit islam. Këtë lloj katolikësh dhe prindërit e tyre Koncili i vendos para dënimit me shkishërim. Grave që ishin martuar me një "turk" u mohoheshin sakramendet, kurse grave, burrat e të cilave ishin kthyer në myslimanë, porse ato vazhdonin të ruanin besimin, u lejohej sakramendet¹³⁵.

130 Ibidem, 38-40.

131 Ibidem, 41.

132 Ibidem, 41-42.

133 Ibidem, 42-45.

134 Ibidem, 45-48.

135 Ibidem, 48-51.

Në pjesën e tretë të akteve të Koncilit flitet për ipeshkvijtë¹³⁶ dhe në të katërtën për famullitarët.¹³⁷ Në kapitullin e katërt të pjesës IV, Koncili i kushton një vëmendje të posaçme misionarëve që vepronin në Shqipëri, të cilët ishin kryesisht françeskanë. Këtyre u kërkohet me rreptësi që të jetojnë sipas rregullave të Urdhrit, të tregojnë bindjen e duhur ndaj eprorëve dhe të vënë në dispozicion të këtyre shtëpitë misionare. Misionarëve i jepeshin edhe këshilla praktike dhe të dobishme: të mos ngisnin kuaj (nuk shihej me sy të mirë nga myslimanët), të mos kryenin studime mjekësie dhe kirurgjie pa miratimin e Selisë së Shenjtë, të mos bëheshin kumbarë për pagëzime e krezmime, si dhe përmes ritualit të prerjes së flokëve të parë tek djemtë ose vajzat, të mos bëheshin nunë as kumbarë, figura aq të dashura e të përhapura në Ballkan.¹³⁸ Ndonëse janë bashkëpunëtorë të ipeshkvijve, në aktivitetin e tyre meshtar, misionarët nuk duhet të jenë të kufizuar prej ipeshkvijve. Përpara se të dërgohen për të dëgjuar rrëfimet e besimtarëve, ata duhet të japin provimin e gjuhës shqipe para Prefektit të Misionit. Prefekti i Misionit për Shqipërinë dhe Serbinë duhet t'i paraqesë Kongregacionit të Propagandës në Romë një relacion baritor mbi territorin përkatës një herë në vit, kurse Prefekti për Maqedoninë dy herë në vit.¹³⁹

Në kapitullin e pestë të pjesës IV¹⁴⁰ ka një shënim tepër interesant të shkollës elementare kishtarë në Kurbin, në arqipeshkvinë e Durrësit, me qëllim arsimimin e priftërinjve të ardhshëm. Kongregacioni i Propagandës e kishte ngritur këtë shkollë qysh përpara Luftës së Madhe Turke, duke emëruar një mësues, me gjasa një françeskan, me rrogë vjetore. Më pas, funksionimi i shkollës ndeshi në vështirësi të mëdha për shkak të trazirave të luftës së sapopërmendur. Për këtë arsye Koncili e ngarkoi rreptësisht mësuesin e atjeshëm (*Corbinensis Ludimagister*) që të kryente detyrën me një zell të posaçëm dhe t'i përmbahej metodave mësimore si vijon: nxënësve t'u mësohet shkrim e këndim, sepse këto janë pjesë e arsimit bazë të një famullitari; arti i të shkruarit nuk duhej nënvlerësuar sepse ata që nuk e zotërojnë, nuk do të mund të mësonin as gjuhën latine, as ritualin kishtar.¹⁴¹ Vetëm pas kësaj, mësuesi mund t'i njihte nxënësit me bazat e gramatikës latine. Më tej, Koncili kërkon shpjegimin e rregullt të katekizmit dhe leximin e konstitucioneve të Koncilit (të vitit 1703), për të njohur ritet kishtarë dhe për të ushtruar siç duhet përkujdesjen shpirtërore. Përveç kësaj, klerikëve

136 Ibidem, 51-74

137 Ibidem, 75-85.

138 K. KASER-S. GRUBER-R. PICHLER (Hrgs), *Historische Anthropologie im südöstlichen Europa: eine Einführung*, Wien 2003, 147-149.

139 Ibidem, 85-89.

140 Ibidem, 90-92.

141 Në këto mangësira Koncili sheh rrënjët e paditurisë së vajtueshme të klerikëve dhe besimtarëve.

u duhej mësuar edhe etika e krishterë (“in semita mandatorum Domini dirigantur, et forma gregis efficiendi, pietatem, Religionem, bonosque mores erudiantur”).¹⁴² Nxënësve u kërkohet që të rrëfeshin njëherë në muaj si dhe për festat e rëndësishme fetare, dhe po të kishin arritur pjekurinë e duhur, të merrnin edhe kungimin e shenjtë. Të shtunën, ose në një tjetër ditë të javës, duhet të mësonin përmendësh librin e “Doktrinės së Krishterë” dhe t’ia pyesnin atë njëri-tjetrit. Sa herë që mësuesi të ushtronte përkujdesje shpirtërore, duhej të merrte me vete klerikë të caktuar për t’i njohur këta me praktikën e përkujdesit shpirtëror. Meqenëse shkolla ndodhej në arqipeshkvinë e tij, arqipeshkvi i Durrësit merrte përsipër se do të mbikqyrte me kujdes që kjo gjë të realizohej, dhe që mësuesi i ngarkuar t’i përmbahej me përpikmëri këtij programi. Të njëjtat rregulla duhej të vlenin edhe për mësuesin e shkollës në Veljë, në dioqezën e Lezhës, dhe përgjegjës për këtë ishte ipeshkvi i Lezhës. Metodatat e mësimdhënies të miratuara nga Konkili duheshin ndjekur edhe në shkollën e Veljës.¹⁴³

Në Romë, vendimet e Konkilit të 1703^{it} nga njëra anë u pritën me entuziazëm dhe nga ana tjetër me dilema. Për shumëkënd, vetëm tani u bë e qartë se sa shumë ishte goditur, gjymtuar e dobësuar Kisha katolike nën sundimin osman në Shqipëri, Serbi dhe Maqedoni. Prandaj u bënë përpjekje të ndryshme për të zbatuar vendimet e Konkilit dhe për të vënë shenja të reja misionare për t’u ardhur në ndihmë të krishterëve në këto krahina të shumëvuajtura. Krahës Kongregacionit të Propagandës që, *ex officio*, e kryente vazhdimisht këtë detyrë, duhen përmendur edhe përpjekjet e Papa Benediktit XIV (1740-1758). Ky kanonist i madh hartoi një seri qarkorësh drejtuar Kongregacionit të Propagandës dhe ipeshkvijve të Shqipërisë e Serbisë, për të rigjallëruar Kishën në Shqipëri e për ta ndihmuar në nevojë. Në këtë vazhdë, në enciklikën e tij “*Inter omnigenas calamitates*” (*Mes shumëlloj fatkeqësish*) të datës 2 shkurt 1744, ai konfirmoi edhe njëherë dekretet e Konkilit. Kjo qarkore, e përbërë nga 28 kapituj dhe një parathënie e shkurtër, u drejtohej gjithë arqipeshkvijve, ipeshkvijve, famullitarëve, klerikëve dhe besimtarëve të Serbisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë.¹⁴⁴ Në këtë shkresë Papa urdhëron pranimin fjalë për fjalë të vendimeve të Konkilit. Mbi të gjitha ai thekson rëndësinë e besimit, pa të cilin të krishterët nuk mund të gëzojnë pëlqimin e Perëndisë. Besimtarëve u jepet zemër dhe u kërkohet që askund të mos e mohojnë besimin tek Jezu Krishti, të mos mbajnë emra turk, të mos shkojnë në xhami për t’u falur. Ata duhet të kremtonin festat katolike dhe të mos hanin mish të premteve.¹⁴⁵

142 Ibidem, 91.

143 Ibidem, 92.

144 *Inter omnigenas calamitates*, in: *Bullarium pontificium Sacrae Congregationis de Propaganda Fide* III, Romae 1840, 106-114.

145 *Inter omnigenas calamitates*, 107.

Më tej Benedikti XIV nënvizon se, të Krishterëve nuk u lejohej të mohonin Krishtin kur pyeteshin nga turqit, nëse ishin katolikë apo myslimanë. Ata duhet ta shpallin besimin në Krisht jo vetëm me zemër, por edhe me gojë (*ore*). Papa gjithashtu ua ndalon marrjen e sakramendeve atyre grave që besojnë në Krisht dhe megjithatë, janë martuar me burra turq. Nëse si nëna, ato do të sillnin për të pagëzuar, prej bindjes ose prej rrezikut nga vdekja, fëmijë të lindur nga martesë të tillë, klerikët nuk duhej të ngurronin që t'i pagëzonin.¹⁴⁶

Koncili në vetvete tregoi mirëkuptim për situatën e vështirë ku ndodheshin të krishterët dhe për shfaqjen e të kriptokrishterëve, madje u lejoi këtyre se nuk ishin të detyruar të “deklaroheshin” besimin e tyre para personave privatë. Kurse përkundrajt autoriteteve dhe institucioneve zyrtare duhej të pranoheshin gjithnjë përkatësinë e tyre në Kishën katolike – qoftë edhe nëse për këtë gjë u kanosej vdekja.¹⁴⁷

Vendimet e Koncilit plenar të vitit 1703, si dhe enciklika të mëvonshme të Papës Benedikti XIV, “*Inter omnigenas calamitates*” e vitit 1744 dhe “*Quod Provinciale Concilium*” e vitit 1754, dekreti i Kongregacionit të Propagandës i datës 19 shkurt 1774, “*Decretum quo reprobantur nonnullae praxes christianorum occultorum muhamethanum sectam simultantium*”, si dhe disa shkresa të tjera të rëndësishme, janë momente historike për aktivitetin misionar në Shqipëri, të cilat u ribotuan më 1803, në njëqindvjetorin e mbajtjes së Koncilit, për të mbështetur më tej punën misionare.¹⁴⁸

3.2.2. Koncili i dytë plenar shqiptar 1871

Jehona e Koncilit të parë plenar shqiptar ishte shumë e madhe si në Romë, ashtu edhe në Shqipëri, Serbi, Maqedoni dhe Bullgari. Veçse vënia në jetë e dekreteve të tij la shumë për të dëshiruar dhe dështoi kryesisht prej numrit të pakët të klerikëve që iu dedikuan punës misionare në këtë rajon. Për rrjedhojë, në shekujt XVIII-XIX Kongregacioni i Propagandës u përpoq të realizonte vendimet e Koncilit, të intensifikonte edukimin dhe arsimimin e klerit, të siguronte mjetet financiare për restaurimin e kishave të vjetra dhe ndërtimin e kishave dhe kapelave të reja, për të afruar e nxitur Urdhra dhe Kongregata të reja në punën misionare dhe sipas mundësisë, për të hapur edhe shkolla katolike. Për këtë arsye, pas 150 vitesh Kongregacioni i Propagandës propozoi që të thirrej një tjetër Koncil plenar për Kishën në Shqipëri.¹⁴⁹ Papa Piu IX e thirri këtë koncil me anë të enciklikës së tij

146 *Istarum vero filios quos parochis baptizandis exhibent, ubi eorum vitae periculum imminere videatur, sacro lavacro ablueri praedicti parochi minime dubitant. Ibidem, 108.*

147 *Ibidem, 109.*

148 *Concilium provinciale sive nationale Albanum, Romae* ² 1803.

149 AP, Congregazione generale 18.aprile 1853.

të 27 shtatorit 1853¹⁵⁰ dhe kryetar emëroi arqipeshkvin e Shkodrës, Gjon Topić (1790-1868),¹⁵¹ një françeskan kroat prej Dalmacie. Topić ishte një murg modest dhe nuk e pa veten në gjendje që të organizonte koncilin.¹⁵² E vështirë ishte edhe gjendja politike në krahinat e katolikëve shqiptarë, çfarë nuk favorizonte mbajtjen e një koncili. Megjithatë Kogregacioni i Propagandës nuk u tërhoq prej bindjes së tij dhe priti një rast tjetër më të favorshëm. Kur situata politike u qetësua, ai i dërgoi të gjithë ipeshkvijve të Shqipërisë një listë me pyetje për të kuptuar, nëse ende ishte e nevojshme mbajtja e një koncili të ri.¹⁵³ Kësaj radhe në rezidencën e Tivarit qëndronte një ish-nxënës i Collegio Urbano, i palodhuri Karl Pooten,¹⁵⁴ lindur në Düren (Rheinland) dhe i emëruar arqipeshkëv për Tivarin e Shkupin më 1867. Kuvendi u zhvillua në kishën katedrale modeste të Shkodrës prej 17 shtatorit deri më 1 nëntor 1871.¹⁵⁵ Qëllimi i Koncilit nuk ishte hartimi i kanoneve të reja apo sjellja e risive të mëdha, por aktualizimi dhe zbatimi i kanoneve dhe vendimive të vitit 1703.

Aktet e Koncili përbëheshin prej katër pjesësh. Në pjesën e parë u ritheksuan vendimet e e vitit 1703 dhe u përforcuan konstitucionet dogmatike të Koncilit të Vatikanit I. Tri pjesët e tjera trajtonin sakramendet, zyrën e ipeshkvijve dhe të famullitarëve si dhe detyrat misionare të tyre në Shqipëri.¹⁵⁶ Në Koncil morën pjesë: Karl Pooten, arqipeshkëv i Tivarit dhe Shkodrës, Raphael de Ambrosio, arqipeshkëv i Durrësit, Darius Bucciarelli, arqipeshkëv i Shkupit, Petrus Severini, arqipeshkëv i Sapës, Franciscus Malczyński, ipeshkëv i Lezhës, Albertus Gracchi, ipeshkëv i Pultit, Gaspar Granić, Abat i Shën Aleksandrit, P. Bonaventura nga Palma, pro-prefekt apostolik i misioneve në Maqedoni, P. Johannes Petrus nga Bergamo, pro-prefekt apostolik i misioneve në Pult, P. Bonaventura nga Ossida, pro-prefekt apostolik i misioneve në Epir. Vendimet e Koncilit plenar u miratuan prej Kongregacionit të Propagandës¹⁵⁷ dhe dolën prej shtypit më 1876.¹⁵⁸ Koncilit i dytë shqiptar nuk arriti të jepte një kontribut të mirëfilltë, me

150 PIUS IX, *Apostolicum ministerium*, 27. September 1853, in: *Jus Pontificium de Propaganda Fide* I/6, Romae 1894, 190.

151 RITZER-SEFRIN, *Hierarchia catholica* VIII, 505.

152 V. BLAŽEVIĆ, *Concilia e synodi in territorio hodiernae Jugoslaviae celebrata*, Vicetiae 1967, 57.

153 AP, *Albania*, Distretto con Sommario, Roma 1865, 1-3.

154 RITZER-SEFRIN, *Hierarchia catholica* VIII, 106; P. VRANKIC, *La Chiesa cattolica nella Bosnia ed Erzegovina al tempo del vescovo fra Raffaele Barišić* (1832-1863), Roma 1984, 157.

155 *Concilium Albanum secundum*, Romae 1876, 118-119.

156 Ibidem, 13-117.

157 AP, *Acta* vol. 244, fol.318,338

158 *Concilium Albanum secundum*, 127.

qëllim përforcimin e aktivitetit misionar në vend. Sikurse edhe në Konkilin e parë shqiptar, edhe në këtë Koncil, një kapitull iu kushtua misionarëve që kishin ardhur në këtë vend.¹⁵⁹

3.2.3. Koncili i tretë plenar shqiptar 1895

Përmes lëvizjeve kombëtare në Ballkan dhe ndryshimeve politike që u sanksionuan në Kongresin e Berlinit, e shtynë edhe Shqipërinë gjithnjë e më shumë në qendër të zgjidhjeve të ardhshme politike. Idea për të mbajtur një koncil të tretë shqiptar u hodh nga Papa Leoni XIII më 8 prill 1894, gjatë një audience ku ai priti Sekretarin e Kongregacionit të Propagandës. Fillimisht kjo shtysë u diskutua në detaj në mbledhjen e radhës së Kongregacionit dhe u miratua me dekretin e 23 prillit të po atij viti.¹⁶⁰ Një prej detyrave kryesore të koncilit të ardhshëm duhej të ishte “incrementum Missionum Albanensium”.¹⁶¹ Koncili u mbodh në Shkodër, prej datës 15 maj deri në 23 qershor 1895, nën kryesinë e Pasquale Guerini,¹⁶² arqipeshkëv i Shkodrës. Koncili u drejtohej të gjithë ipeshkvijve dhe prefektëve misionarë të Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë jugore.¹⁶³ Gjatë kuvendit u konfirmuan vendimet dhe dekretet e Koncilit I dhe II plenar shqiptar, të cilat u rinovuan dhe iu përshtatën rrethanave të reja kishtarë dhe politike.¹⁶⁴ Në perfundim, Koncili shprehu lavde dhe mirënjohje për punën misionare të bërë nga pjesëtarë të Urdhrave të ndryshëm fetarë në Shqipëri.¹⁶⁵ Aktet e Koncilit u miratuan prej Kongregacionit të Propagandës më 30 korrik 1897 dhe u botuan prej Kongregacionit po atë vit.¹⁶⁶

4.0. Përfundim

Në shekujt XVIII-XIX gjendja e Kishës katolike në Shqipërinë veriore dhe qendrore ishte tepër e rëndë. Mungonte gjithçka: nuk kishte priftërinj të mirëarsimuar dhe misionarë të aftë, s’kishte shkolla, as ndërtesa kishtarë dhe as besimtarë të ushtruar. Këto kushte ishin të njohura si për Kongregacionin e Propagandës në Romë, për ipeshkvijtë, priftërinjtë, misionarët, ashtu edhe për përfaqësuesit e huaj dhe udhëtarët në vend. Tre koncilet plenare, të mbajtura në fillim të shek. XVIII dhe në gjysmën e dytë të shek. XIX, nuk arritëm të ndikonin për një përmirësim të dukshëm

159 Ibidem, 109-117.

160 *Concilium Albanum tertium provinciale sive nationale*, Romae 1897, 5.

161 Ibidem.

162 RITZER-SEFRIN, *Hierarchia catholica* VIII, 506.

163 *Concilium Albanum tertium*, 6-7.

164 Aktet e Koncilit nuk janë aq të vëllimshme sa dy pararendësit dhe përbëhen po nga katër kapituj.

165 *Concilium Albanum tertium*, 53-55.

166 Ibidem, 3-4.

të situatës. Vetëm puna e përditshme dhe e lodhshme pastorale, arsimore dhe iluministe e klerikëve vendas dhe e misonarëve të huaj arriti që, me kohë, të japi frytet e veta.

Aspektet më të rëndësishme të katolicizmit shqiptar gjatë shekujve XVIII-XIX, që do të kishin kërkuar një vëmendje të posaçme, të vazhdueshme dhe një qasje plot takt, si nga ana e Romës, ashtu edhe nga ajo e ipeshkvijve, barinjve shpirtërorë dhe e misonarëve në terren, aspekte këto që u evidentuan në të tre Konkilet, kishin të bënë kryesisht me zakone pagane shumë të përhapura qysh prej kohës ilire-parakristiane, që manifestoheshin në format e mëposhtme: përzierje e kulteve pagane me ato kristiane, besimi tek vampirët dhe shpirtrat e këqinj (xhind), përhapja e hajmalive, prania e hakmarrjes mes familjeve e fiseve armike.¹⁶⁷ Me pushtimin osman dhe përhapjen e islamit pasoi një formë unike e sinkretizmit fetar mes krishtëritimit, islamit dhe paganizmit, i cili manifestohet më së miri në fenomenin e kriptokrishterëve dhe dëshirës për t'ua ndarë sakramentet edhe të afërmeve myslimanë si shenjë dashamirësie dhe e lidhjes farefisnore.¹⁶⁸ Sinkretizmi fetar i sipërpërmendur dhe afërsia me islamin krijuan disa kushte që e pamundësuan një lidhje martesore dhe të jetuarit e saj sipas përfytyrimeve dhe mësimave të kishës. Në një shoqëri rurale dhe baritore, pjesërisht të përdhosur, të kontrolluar dhe të shtypur prej islamit, roli i gruas ishte dobësuar mjaft përmes rrëmbimit, martesës së detyruar dhe poligamisë.¹⁶⁹ Këtyre ndikimeve të jashtme, ndaj të cilëve Kisha ishte vazhdimisht e ekspozuar dhe zor se mund t'i ndikonte ose zbuste disi, u shtoheshin për rrjedhojë logjike edhe dobësitë e problemet e Kishës dhe të shoqërisë shqiptare, të cilat mund të pëmbliidhen shkurtimisht si vijon: mungesa e shkollave elementare dhe të larta, arsimim i keq ose mungesa e tij në rradhët e klerit vendas, pamundësi e klerit të huaj, e ipeshkvijve, misonarëve dhe priftërinjve që të familjarizoheshin me gjuhën, mendësinë dhe jetën zakonore të shqiptarëve, skamja e përgjithshme e popullsisë,

167 Një frat bosniako-kroat, Lovro Mihačević, që është marrë gjatë me hulumtimin e fenomenit të kriptokrishterëve, si një forme e sinkretizmit fetar në Shqipëri, na ka lënë pas një dëshmi interesante prej fillim shek. të 20. „Shqiptarët janë të përshtirshëm, shkojnë me kënaqësi në kisha e xhamia, edhe i nderojnë fort priftërinjtë e tyre. Po ashtu falin lemoshë, vizitojnë të sëmurët dhe marrin zotime të ndryshme. Ata përvetësojnë lehtë gjërat e huaja, sidomos malësorët, por nuk do ta shkelnin agjërimin për asgjë në botë. Një njeri e vrasin për diçka fare të vogël, dhe njëkohësisht do të vdisnin për besimin, nëse ky do të shahet nga dikush. Shkeljen e kurorës e konsiderojnë një mëkat të madh, por njëkohësisht mbajnë dy gra, çka lejohet sipas pikëpamjes së tyre...Ata besojnë në vampirë, shtojzavalle, zana mali dhe ...në ‚Dschins‘ (xhind - shën. i përkth.), në syrin e keq dhe gjëra të ngjashme. Kundër gjithë këtyre gjërave ata përdorin hajmalitë, që i marrin prej priftërinjve dhe hoxhallarëve. L. MIHAČEVIĆ, *Durch Albanien. Reise-Eindrücke*, Prag 1913, 32-33; E. DEUSCH, 127.

168 Kjo u luftua me forcë nga të gjithë konkilet.

169 *Concilium Provinciale sive Nationale Albanum*, 1706, 48-51.

mungesa e pranisë së klerit dhe e individëve të arsimuar katolikë në jetën publike të vendit.¹⁷⁰

Përtej kësaj, afësia dhe bashkëjetesa e katolikëve dhe e myslimanëve në Shqipërinë veriore dhe në Kosovë kanë mundësuar diçka, që paraqet interes tepër të madh për ne dhe bashkëkohësit, që ende nuk është hulumtuar siç duhet, dhe që na kujton bashkekzistencën paqësore mes feve botërore. Frati i sipërpërmendur françeskan, Lovro Mihačević, na ka lënë pas një dëshmi të fillim shekullit XX që na bën të reflektojmë: sipas zakonit te vjetër, mesha në stinën e verës mbahej në varreza, duke bekuar kështu edhe arat sipas zakonit kishtar; gjithnjë të pranishëm janë këtu edhe muhamedanët, sepse ata e dinë mirë që në këto varreza prehen edhe paraardhësit e tyre. Po, shpesh vjen herët në mëngjes një muhamedan tek famullitari, merr hejbetë me petkat e meshës dhe i dërgon në varrezë, ndërsa vëllai i tij sjell dërrasat – altarin portativ – të ruajtura në shtëpinë e vet. Pas meshës, katolikë e myslimanë ftojnë miq në shtëpitë e tyre, dhe konkretisht muhamedanët ftojnë jo vetëm myslimanë, por edhe katolikë, e po kështu katolikët ftojnë si bashkëbesimtarë të tyre dhe muhamedanë. Nëse prifti katolik shkon të bekojë shtëpitë rreth famullisë, atëherë i duhet patjetër të vizitojë e spërkasë me ujë të bekuar edhe shtëpitë myslimane, të cilat në këmbim japin lëmoshë njëlloj si katolikët; ata do të fyheshin shumë sikur ai të mos e bënte këtë gjë, nëse në një shtëpi muhamedane sëmurej dikush, atëherë shpesh i çohet fjalë priftit që të lexonte meshën, ose të ndizte një qiri për nder të Shën Kollit ose Shna Ndout.¹⁷¹

Megjithë varfërinë e madhe, mungesat, padijen dhe dobësitë e pranisë katolike në Shqipërinë veriore e qendrore gjatë sundimit pesëqindvjeçar osman, megjithë vrazhdësinë e pakuptueshme të ligjit të pashkuar (Kanunit) të fiseve malësore shqiptare, Kisha katolike, si përmes priftërinjve, misionarëve, ipeshkvijve dhe mësuesve vendas shqiptarë, edhe përmes atyre të huaj, italianë, kroatë, gjermanë dhe polakë, nuk ishte vetëm udhërrëfyese dhe misionare e besimit të krishterë, por edhe bartëse kryesore e hovit kulturor, kombëtar dhe fetar, dhe kjo gjë nuk ndodhte vetëm për shqiptarët katolikë.

Përktheu nga gjermanishtja Raim Beluli

170 Si ilustrim për ndryshimet që po ndodhnin dhe për prezencën vazhdimisht të munguar të priftërinjve në çdo lokalitet, na vjen në ndihmë shkresa e ipeshkvit të Pultit drejtuar ambasadës austriake në Vatikan, e datës 10 maj 1897: “Është një fakt i provuar...nga eksperiencia, që ato fise, që ishin më gjakësore, më të dhunshme dhe të pabindura, ndryshonin gradualisht sjellje sapo të kishin një prift në gjirin e tyre, numri i krimeve zvogëlohej, dhe ata bëheshin më njerëzorë”. Shkresë e ipeshkvit të Pultit, Nicola Marconi, drejtuar Mons. Montel në Romë, Pult, 10.5.1897, PA XII/302, Liasse 30; E. DEUSCH, 133.

171 L. MIHAČEVIĆ, 34-35.

Abstract

Starting with the history of the Catholic Church in late antiquity in the territories of present day Albania and Kosove, Prof. Vrankic illustrates the most salient historical moments of the local church. The dioceses of Tivar, Shkup, Shkodra and Durrës were the outposts of Catholicism in Albania (16 - 19th centuries) After the fall of Byzantium the Ottoman empire started expanding constantly thus threatening Albanian Roman Catholics. Under the new circumstance which changed radically only in 1912, the Roman Catholic Church in Albania had to react promptly in order to prevent the expansion of Islam and enhance Catholicism in this part of the Balkans.

In fact, in the second part of his essay Prof. Vrankic focuses on three Synods held in Albania, namely that of 1703, 1871, and 1875 and analyses specific aspects of each one of them.